

GJYKATA KOMUNALE NË PEJË
LËNDA P. Numër 685/09
5 gusht 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Gjyqtari Malcolm Simmons, Krytar i Trupit Gjykses, proces-
mbajtëse Christin Nilsson, në lëndën penale kundër (1)
Gjergj Lulit (në vijim "i Pandehuri i Parë") dhe (2) Kole
Krasniqit (në vijim "i Pandehuri i Dytë") të dy të akuzuar
sipas Aktakuzës numër PP. 1644/09 e ngritur nga Prokurori
Komunal në Pejë, datë 3 shtator 2009 dhe e ndryshuar me
datë 29 janar 2010 për veprën penale të Dhënies së
Deklarimit të Rrejshëm nga neni 307 (1) i Kodit Penal të
Kosovës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë
14 korrik, 21 korrik, 22 korrik dhe 5 gusht 2010 në të
cilin ishin të pranishëm Znj. Alenka Sagmeister-Ranzinger
nga Zyra e Prokurorisë Komunale dhe të pandehurit të cilët
nuk ishin të përfaqësuar, me datë 5 gusht 2010 mori dhe
shpalli publikisht si në vijim

AKTGJYKIM

I pandehuri i parë GJERGJ LULI, emri i babait Pashk Luli,
emri i nënës Zoje, mbiemri i vajzërisë Biblekaj, lindur me
datë 15 shkurt 1978 në Gjakovë, numri i letërnjoftimit
2002986127, Shqiptar Kosovar, me vendbanim aktual në
fshatin Doblibare, i martuar me dy fëmijë është

FAJTOR

Se me datë 11 mars 2009 kur është paraqitur si dëshmitar në
Gjykatën e Qarkut në Pejë në lëndën kundër Gjeloš
Krasniqit ai ka dhënë deklaratë të rrejshme duke deklaruar
se me datë 24 mars 1999 ai nuk e njohte Gjeloš Krasniqin,
se me datë 24 mars 1999 Gjeloš Krasniqi së bashku me 4
ushtarë të tjerë të UCK-së nuk kishte hyrë në shtëpinë e
Pashk Lulit në Doblibare, dhe se për këtë arsye Gjeloš
Krasniqi nuk kishte marrë pjesë në pengmarrjen e Pashk
Lulit edhe pse ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Siç u tha më lart, i Pandehuri i Parë ka kryer veprën

penale të Dhënies së Deklaratës së Rrejshme nga neni 307
(1) i Kodit Penal të Kosovës dhe

DËNOHET

Me 5 muaj burgim me kusht në pajtim me Nenin 43 të Kodit Penal të Kosovës për një periudhë kohore dy vjetësh nga kjo datë.

Bazuar në nenin 102 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i Pandehuri i Parë do të paguajë shpenzimet e procedurës penale të cilat gjykata i vlerëson në shumën prej 100 (njëqind) euro. I Pandehuri i Parë do të paguajë edhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro.

I Pandehuri i Dytë, KOLE KRASNIQI, emri i babait Gjon, emri i nënës Gjyste, mbiemri i vajzërisë Skeli, lindur më datë 24 qershor 1950 në Nepole, numri i letërnjoftimit 1003357119, shqiptar kosovar, aktualisht me vendbanim në fshatin Doblbare, i martuar, baba i 5 fëmijëve është

FAJTOR

Se me datë 31 mars 2009 në paraqitjen e tij si dëshmitar në Gjykatën e Qarkut në Pejë në lëndën kundër Gjeloš Krasniqit ai ka dhënë deklaratë të rrejshme duke deklaruar se nga data 24 mars 2009 deri me datë 25 mars 2009 Gjeloš Krasniqi kishte qenë me të dhe ushtarë të tjerë të UCK-së në shtëpinë e Pashk Krasniqit në fshatin Nepole duke festuar bombardimet, edhe pse ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Për këtë arsye i Pandehuri i Dytë ka kryer veprën penale të Dhënies së Deklaratës së Rrejshme nga neni 307 (1) i Kodit Penal të Kosovës

DËNOHET

Me 5 muaj burg.

Bazuar në nenin 102 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i Pandehuri i Dytë do të paguajë shpenzimet e procedurës penale të cilat gjykata i vlerëson në shumën prej 100 (njëqind) euro. I Pandehuri i Dytë do të paguajë edhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro.

ARSYETIMI

Aktakuza e ngritur nga Zyra e Prokurorisë Komunale më numër PP. 1644/09 datë 3 shtator 2009 dhe ndryshuar me datë 29 janar 2010 ka akuzuar nëntë të pandehur për Dhënie Deklarash të Rrejshme në kundërshtim me nenin 307 (1) të Kodit Penal të Kosovës.

Me datë 14 korrik 2010, në pajtim me nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës kjo gjykatë ka veçuar lëndën kundër të Pandehurit të Parë dhe të Dytë, Bekim Luli, Engjëll Luli dhe Prenk Luli nga lënda kundër katër të pandehurve të tjerë të cilët nuk janë paraqitur në seancën e parë, Pren Kashnjeti, Mihill Pergega, Gjergj Quni dhe Pashk Krasniqi. Me datë 21 korrik 2010 Gjykata veçoi lëndën kundër të Pandehurit të Parë dhe të Dytë nga lënda kundër Bekim Lulit, Engjëll Lulit dhe Prenk Lulit.

Ishte qëndrimi i prokurorisë kundër të Pandehurit të Parë se me datë 11 mars 2009 kur është paraqitur si dëshmitar në Gjykatën e Qarkut në Peja në lëndën kundër Gjelosh Krasniqit ai ka dhënë një deklaratë të rrejshme duke deklaruar se me datë 24 mars 1999 ai nuk njihte Gjelosh Krasniqin, se me datë 24 mars 1999 Gjelosh Krasniqi së bashku me 4 ushtarë të tjerë të UCK-së nuk kishte hyrë në shtëpinë e Pashk Lulit në Doblibare, dhe se për këtë arsye Gjelosh Krasniqi nuk kishte marrë pjesë në pengmarrjen e Pashk Lulit edhe pse ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Ishte qëndrimi i Prokurorisë në lëndën kundër të pandehurit të dytë se me datë 31 mars 2009 në paraqitjen e tij si dëshmitar në Gjykatën e Qarkut në Pejë në lëndën kundër Gjelosh Krasniqi ai ka dhënë deklaratë të rrejshme duke deklaruar se nga data 24 mars 2009 deri me datë 25 mars 2009 Gjelosh Krasniqi kishte qenë me të dhe ushtarë të tjerë të UCK-së në shtëpinë e Pashk Krasniqit në fshatin

Nepole, edhe pse ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Nuk kontestohet se me datë 29 prill 2009 në lëndën numër 67/09 Gjeloš Krasniqi është dënuar nga një trup gjykues i gjykatës së qarkut në Pejë për krime lufte kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të FSRY, neni 3 dhe 147 i Konventës së 4 të Gjenevës, neni 4 i Protokollit të II Shtesë të Konventave të Gjenevës, kryer në fshatin Doblibare në komunën e Gjakovës, me datë 24 mars 1999.

Neni 307 (1) parasheh

Një dëshmitar, dëshmitar ekspert, përkthyes i cili në procedurë gjyqësore, në procedurë për kundërvajtje, në procedurë administrative para noterit publik ose në procedurën disiplinore jep deklaratë të rreme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Gjykata gjen se deklarata e rreme duhet të lidhet me një fakt material dhe dëshmitari ka ditur se deklarata ishte e rreme apo nuk kishte baza të arsyeshme për të besuar se deklarata ishte e vërtetë.

1. I Pandehuri i Parë

I Pandehuri i Parë ka dëshmuar para Gjykatës së Qarkut në Pejë në lëndën kundër Gjeloš Krasniqi me datë 11 mars 2009¹.

Përpara dëshmisë së tij në këtë Gjykatë i pandehuri ka dhënë gjashtë deklarata lidhur me faktet në pyetje.

Me datë 18 janar 2003 i Pandehuri i Parë ka dhënë një deklaratë hetuesve të TPNJ²-së.

Me datë 2 mars 2003 i ppandehuri i parë ka dhënë një tjetër deklaratë hetuesve të TPNJ-së³.

¹ Prova P7

² Prova P1

³ Prova P2

Me datë 16 janar 2008 i Pandehuri i Parë ka dhënë një deklaratë në policinë e UNMIK-ut⁴.

Me datë 1 mars 2008 i Pandehuri i Parë ka dhënë edhe një deklaratë tjetër në policinë e UNMIK-ut⁵.

Me datë 26 gusht 2008 i Pandehuri i Parë ka dhënë edhe një deklaratë tjetër në policinë e UNMIK-ut⁶.

Me datë 7 tetor 2008 i Pandehuri i Parë ka dhënë edhe një deklaratë tjetër në policinë e UNMIK-ut⁷.

Aktakuza pretendonte se i Pandehuri i Parë ka dhënë një deklaratë të rrejshme kur ka dëshmuar në gjykatë me datë 11 mars 2009 duke kryer në këtë mënyrë veprën penale nga Neni 307 (1) i KPK-së.

Qëndrimi i Prokurorisë ishte se dëshmia e dhënë nga i Pandehuri i Parë para gjykatës me datë 11 mars 2009, në shumë aspekte materiale, ishte e rrejshme dhe kundërshtonte deklaratat e tij të mëparshme.

1.1 Deklarata e dhënë para hetuesve të TPNJ-së me datë 18 janar 2003⁸.

I Pandehuri i Parë ka deklaruar se me datë 24 mars 1999 rreth orës 20.30, pesë ushtarë të UCK-së me rroba kamuflazh ngjyrë të gjelbër kanë hyrë në shtëpinë e babait të tij, Pashk Luli.

Ai tha se njihte njërin prej ushtarëve dhe ai është prezantuar si Gjelosh Krasniqi. Ai e dinte se ky person ishte nga fshati Nepole, komuna e Pejës dhe se ishte rreth 30 vjeç.

I Pandehuri i Parë tha se ushtarët ishin të armatosur dhe në mëngët e tyre kishin emblemat e UCK-së.

I Pandehuri i Parë deklaroi se Gjelosh Krasniqi u kishte

⁴ Prova P3

⁵ Prova P4

⁶ Prova P5

⁷ Prova P6

⁸ Prova P2

thënë atyre se babai i tij duhej të shkonte me ta. Bazuar në deklaratën e të Pandehurit të Parë, Gjeloš Krasniqi tha në vazhdim "nëse Gega jep leje ata do t'a lirojnë atë".

I Pandehuri i Parë deklaroi se ushtarët kishin pyetur nëse Pash Luli kishte armë.

I Pandehuri i Parë deklaroi se pasi që ushtarët kishin marrë babain e tij, ata kishin lënë një ushtar aty për të mbikqyrur njerëzit në oborr dhe ka shkuar me babain e tij në shtëpitë e Ded Quni, Mhill Pergega, Tune Kashnjeti dhe kanë marrë armë për ata. Pastaj ata janë kthyer dhe janë larguar nga oborri duke marrë me vete Pashk Lulin.

I Pandehuri i Parë deklaroi se ndërsa po largoheshin, Gjeloš Krasniqi ka bërë titur se ata do të vrisnin Pashk Lulin "si qen".

I Pandehuri i Parë deklaroi më tej se Gjeloš Krasniqi në atë kohë jetonte në New York dhe se motra e tij Marta e kishte informuar atë se në gusht të vitit 2002, Gjeloš Krasniqi i kishte bërë asaj vizitë në agjensinë e udhëtimit në New York ku ajo punonte dhe kishte thënë "Kam vrarë babain tënd dhe nuk m'a ndin hiç as për ty".

1.2 Deklarata e dhënë para hetuesve të TPNJ-së me datë 2 mars 2004⁹.

I Pandehuri i Parë deklaroi se kishte frikë të zbulonte emrat e dy personave që mund të jenë të përfshirë në rrëmbimin e babait të tij. Ai i kishte mësuar këta dy emra nga Gjeloš Krasniqi të cilin ai e ka identifikuar si rrëmbyesi i babait të tij, kur e ka takuar atë në fshatin e tij Doblibare, dhe e ka pyetur atë për vendndodhjen e babait të tij.

I Pandehuri i Parë deklaroi se Gjeloš Krasniqi e kishte informuar atë se ai kishte shoqëruar babain e tij në fshatin Maznik. Ai ka sugjeruar se nëse i Pandehuri i Parë donte të dinte se çfarë kishte i ndodhur babait të tij atëherë ai duhej të shkonte në Shtabin e Përgjithshëm të UCK-së në Jabllanicë dhe të fliste me Lahi Brahimajn dhe Maliq Ndrecajn.

⁹ Prova P3

I Pandehuri i Parë deklaroi më tej se natën kur babai i tij është marrë, ishte errësirë dhe ai ka mundur të identifikojë vetëm Gjelosh Krasniqin.

1.3 Deklarata e dhënë para policisë së UNMIK-ut me datë 16 janar 2008¹⁰.

I Pandehuri i Parë deklaroi se në vitin 1998 një person me emrin Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, komuna e Pejës, ka ardhur së bashku me tre persona të tjerë në Doblbare dhe kanë vjedhur një automjet Mercedes 190 pronë e Pal Ndrecajt.

Pas informimit të Shtabit të Përgjithshëm të UCK-së, ushtarë të UCK-së kanë shkuar në shtëpinë e Gjelosh Krasniqit në Nepole, kanë marrë automjetin dhe ia kanë kthyer atë Z. Ndrecajt.

Duke iu referuar ngjarjeve të datës 24 mars 1999, i Pandehuri i Parë deklaroi se rreth orës 20:15 Gjelosh Krasniqi, veshur me një xhakëtë kamuflazh pa emblemë të UCK-së, ka hyrë në oborrin e shtëpisë, u ka thënë atyre që të mos kenë frikë sepse ata ishin ushtarë të UCK-së dhe pastaj ka kërkuar një Mercedes pronë e "Tule". I pandehuri i parë tha se ata nuk kishin Mercedes por vetëm një VW Golf i cili nuk punonte mirë.

I Pandehuri i Parë deklaroi se Gjelosh Krasniqi i ka pyetur "cili prej jush është oficer i policisë lokale përndryshe do të ju dërgojmë të gjithëve në Shtabin e UCK-së në Jabllanicë". Babai i të Pandehurit të Parë është ngritur në këmbë dhe iu ka thënë se ai ishte oficeri i policisë lokale në pyetje. Gjelosh Krasniqi i ka kërkuar atij armët e tij. Gjelosh Krasniqi ka sekuestruar një AK-47 dhe një pistoletë 7.65mm të poseduara nga babai i të Pandehurit të Parë.

Pas sekuestrimit të armëve, Gjelosh Krasniqi ka urdhëruar ushtarët e tjerë që të kontrollojnë personat e tjerë të pranishëm. Pas kësaj, ata morën babain e të pandehurit të parë, lanë një person në vend dhe shkuan në fshat për të kërkuar armë.

I Pandehuri i Parë deklaroi se rreth orës 23:30 Gjelosh Krasniqi është kthyer me babain e tij. Ata kanë pirë ujë

¹⁰ Prova P

dhe Gjelosh Krasniqi i tha babait të tij se ai duhej të shkonte me ta në Shtabin e tyre.

I Pandehuri i Parë deklaroi se katër ditë pas luftës ai ka takuar Gjelosh Krasniqin në shtëpinë e Pashk Përgegës në fshatin Doblibare. I Pandehuri i Parë i ka kërkuar Robert Përgegës që të thërrasë Gjelosh Krasniqin dhe t'a pyesë atë se ku ka lënë babain e tij.

I Pandehuri i Parë deklaroi se Gjelosh Krasniqi e ka informuar atë se ai kishte lënë babain e tij në fshatin Maznik, se ai nuk dinte asgjë për të dhe se ai nuk duhej të shqetësohej dhe t'a kërkonte sepse mund të humbiste si babai i tij. I pandehuri i parë deklaroi se, kur ka pyetur se pse, Gjelosh Krasniqi është përgjigjur se ai duhej të largohej përndryshe do ta bënte fshatin "shkrum e hi".

I Pandehuri i Parë deklaroi se, pas luftës, Gjelosh Krasniqi kishte shkuar në SHBA ku kishte takuar motrën e të Pandehurit të Parë, Marta Nrecaj, në vendin e saj të punës në një agjensi udhëtimi dhe i ka thënë asaj se babai i saj ishte varrosur afër shtëpisë së tyre.

1.4 Deklarata e dhënë para policisë së UNMIK-ut me datë 1 mars 2008¹¹.

I Pandehuri i Parë deklaroi se me datë 20 shkurt 2008 ai kishte thirrur oficerin e policisë Hazbi Axhami për t'a informuar atë për disa kërcënime që ai thoshte se kishte marrë.

I Pandehuri i Parë deklaroi se një shok i tij, gjatë një bisede me Gjelosh Krasniqin, i kishte thënë këtij të fundit se djemtë e Pashkut ishin duke u rritur dhe sikur ai të ishte në vend të tij (Gjelosh Krasniqit) ai nuk do të ndihej kaq i lirë duke u sjellë përreth. Pretendohet se Gjelosh Krasniqi i është përgjigjur se do t'a vriste atë dhe do t'a zhdukte njësoj si babain e tij.

I Pandehuri i Parë deklaroi se ai dhe familja e tij ishin të frikësuar nga Gjelosh Krasniqi sepse ai ishte shumë i rrezikshëm.

¹¹ Prova P

1.5 Deklarata e dhënë nga dëshmitari para policisë së UNMIK-ut me datë 26 gusht 2008¹².

I Pandehuri i Parë deklaroi se me datë 24 mars 1999 kur është marrë babai i tij, Gjelosh Krasniqi bashkë me katër persona të tjerë kishin dhënë urdhër personavë që ishin në oborr që të qëndronin aty për dy orë. I Pandehuri i Parë dhe xhaxhai i tij Mark Luli ishin afër derës së oborrit kur Gjelosh Krasniqi, i cili mbante Pashk Lulin me një dorë, ka kaluar derën. Pas pak kohe, i Pandehuri i Parë ka hapur derën por Gjelosh Krasniqi e ka parë atë dhe ka thënë "mbylle derën dhe do t'a vras atë si qen".

I Pandehuri i Parë deklaroi më tej se një muaj para se të jepte deklaratën, ndërsa ai gjendej në një pompë benzine, ai ka dëgjuar një bisedë mes dy personave të cilët kanë thënë "Gjelosh Krasniqi është në telashe me një djalë nga fshati Doblibare dhe duhet të shkojmë në shtëpinë e tij".

I Pandehuri i Parë deklaroi se me datë 6 gusht 2008 Pal Krasniqi ka shkuar tek i Pandehuri i Parë dhe i ka kërkuar atij "që të ndihmojë Gjelosh Krasniqin dhe të tërheqë akuzat kundër tij" sepse ai nuk ka lidhje me vrasjen e Pashkut".

1.6 Deklarata e dhënë para policisë së UNMIK-ut me datë 7 tetor 2008¹³.

I Pandehuri i Parë deklaroi se ai donte të tërhiqte akuzat kundër Gjelosh Krasniqit sepse babai i tij "kishte uniformën e gabuar të policisë serbe", ai kishte humbur prej një kohe të gjatë dhe ata donin të jetonin një jetë të qetë.

I Pandehuri i Parë deklaroi se ai nuk kishte qenë i kërcënuar dhe se edhe pse ai kishte parë më parë Gjelosh Krasniqin duke shëtitur në Gjakove dhe e kishte akuzuar atë, tani ai donte të tërhiqte të gjitha akuzat.

1.7 Dëshmia e dhënë para Gjykatës së Qarkut në Pejë me datë 11 mars 2009¹⁴.

¹² Prova P

¹³ Prova P

¹⁴ Prova P

Gjatë dhënies së dëshmisë së tij me datë 11 mars 2009 i Pandehuri i Parë deklaroi se nuk ka njohur asnjë nga ushtarët natën kritike por vetëm se njëri nga ta është prezantuar si Gjelosh Krasniqi; se Gjelosh Krasniqi nuk ishte personi që ai kishte parë natën kritike; se ai nuk kishte parë kurrë Gjelosh Krasniqi më parë; se ai nuk kishte parë ngjyrën e uniformave që kishin veshur ushtarët dhe nuk kishte parë asnjë emblemë të UCK-së.

I Pandehuri i Parë është ballafaquar me kundërshtimet mes dëshmisë së tij të dhënë në Gjykatë në atë rast dhe deklaratat e tij të mëparshme.

Prokurori Publik: Me leje të gjykatës, dëshiroj të kthehem tek deklaratat e tij të mëparshme, dosja 2, nëndosja 30, me datë 17 janar 2003; si dhe me datë 18 janar 2003 në faqen 172.
Por po filloj të lexoj këtë. Dëshiroj të ju pyes, a e njihni Gjelosh Krasniqin?

Gjergj Luli: Jo, nuk e njoh.

Prokurori Publik: Do të shkoj në faqen 172, paragrafi i fundit dhe sipas deklaratës që ju keni dhënë para hetuesve ju keni thënëse me datë 24 mars 1999, në orën 20:30 "pesë të UCK-së, me uniforma të gjelbërta kamuflazh kanë hyrë në shtëpinë e babait tim në Doblibare. Unë kam njohur njërin prej tyre dhe ai është prezantuar si Gjelosh Krasniqi."

Kryetari i Trupit Gjykses: Kemi një mospërputhje të madhe që është lexuar nga Prokurori Publik dhe deklaratë që ju dhatë në gjykatë para pesë minutash. A mund të na spjegoni? Pse keni deklaruar para TPNJ-së se ju keni njohur Gjelosh Krasniqi dhe pesë persona me uniforma të UCK-së kanë hyrë në shtëpinë e babait tuaj?

Gjergj Luli: Ata nuk kanë hyrë në shtëpinë e babait tim dhe unë nuk e kam njohur Gjelosh Krasniqin. Kjo guhet të qartësohet. Dhe nuk kam thënë kurrë se ata kishin veshur uniforma ngjyrë të gjelbër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Këtu është e shkruar dhe e nënshkruar nga ju. Pra jeni duke thënë se...
(ndërpritet)

Gjergj Luli: Po, por përkthyesi... (interrupted)

Avokati Mbrojtes: Ai po thotë se askush nuk ka lexuar atë që është nënshkruar nga përkthyesi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju keni dhënë deklaratën në shqip?

Gjergj Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si e keni nënshkruar këtë versionin në gjuhën angleze?

Gjergj Luli: Pasi dhashë deklaratën, ishte një hetues ndërkombëtar Kelly, dhe e kam nënshkruar dhe ishte edhe Hazbije.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por shkruhet edhe se deklarata e tij të cilën përmendi Prokurori Publik, më është lexuar në shqip, anglisht dhe kjo është e vërtetë me sa di unë e me sa më kujtohet dhe nënshkrimi juaj.

Gjergj Luli: Nuk është lexuar. Ata më pyetën nëse dëshiroja t'a lexoja por nuk e lexova.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është nënshkruar nga ju por ky është një nënshkrim që thotë se kjo deklaratë e cila është në anglisht ju është lexuar në shqip. Ky është pohimi juaj, pra kini kujdes sepse e dini se dëshmitari është i detyruar të thotë të vërtetën dhe se dëshmia e rreme është vepër penale. Pra ju insistoni se deklarata e datës 18 janar 2007 nuk ju është lexuar në gjuhën shqipe?

Gjergj Luli: Nuk është lexuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Lidhur me faktin se ju nuk e njihni Gjelosh Krasniqin, ju thatë se një person është prezantuar si Gjelosh Krasniqi, a është e vërtetë kjo?

Gjergj Luli: Po, nuk e kam njohur më parë por ai person u prezantua si Gjelosh Krasniqi.¹⁵

¹⁵ Pjesë nga procesverbali i shqyrtimit kryesor datë 11.03.2009, faqet 13 - 14

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Lidhur me uniformat. Në deklaratë thuhet se këta "5 ushtarë të UCK-së me kamuflazh të gjelbërt kanë hyrë në shtëpinë e babait tim". Si keni mund të thoni se ata ishin ushtarë të UCK-së?

Gjergj Luli: Nuk e kam përmendur asnjëherë ngjyrën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nuk më intereson ngjyra; më intereson të di si e keni ditur se ata ishin ushtarë të UCK-së?

Gjergj Luli: Nuk kam thënë UCK sepse ata nuk kishin emblema.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po këto ishin fjalët tuaja.

Gjergj Luli: Kam thënë në deklaratë të tjera se nuk kam parë UCK apo shenja të tjera.

Kryetari i Trupit Gjykses: A është e mundur që disa nga këta persona të kenë thënë se ishin UCK?

Gjergj Luli: Asnjëri prej tyre nuk ka thënë këtë.

...

Prokurori Publik: Dëshiroj të vazhdoj aty ku mbeta. Sipas deklaratës ju keni thënë (duke iu referuar Gjeloš Krasniqit), E kam ditur se ai ishte nga fshati Nepole në komunën e Pejës dhe se ishte rreth 30 vjeç. Të gjithë ushtarët e UCK-së ishin të armatosur dhe kishin emblema të UCK-së në mëngët e tyre. Si ka ardhur kjo në deklaratën tuaj, sepse më parë ju thatë diçka tjetër?

Gjergj Luli: Nuk kam thënë asnjëherë asgjë lidhur me emblemat, kjo nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Por ju e keni nënshkruar atë.

Gjergj Luli: E kam nënshkruar por nuk e kam thënë këtë gjë.

Prokurori Publik: Nëse shkojmë në faqen 174, ju keni thënë hetuesve si në vijim, 'për shkak se njihja Gjeloš Krasniqin më parë dhe e pashë atë personalisht duke hyrë në shtëpinë e babait tim me uniformë të UCK-së, jam një qind për qind i sigurtë se ishte ai që mori babain tim, pavarësisht a ishte në UCK apo jo.'

Gjergj Luli: Kjo nuk është e vërtetë

Prokurori Publik: Ju e keni nënshkruar atë.

...

Kryetari i Trupit Gjykses:...Prokurori Publik po ju tërheq vëmendjen në faktin se ju keni thënë Gjykatës se nuk e njihni Gjeloš Krasniqin, ndërsa në këtë deklaratë ju keni thënë në dy raste se e keni parë atë duke hyrë i veshur me uniformë të UCK-së

...

Gjergj Luli: Nuk e njoh, ai është prezantuar si Gjeloš Krasniqi, dhe pra nuk shoh ndonjë mospërputhje.

Kryetari i Trupit Gjykses: ...Ju thoni vazhdimisht se nuk njihni Gjeloš Krasniqin, por a nuk e njihni tani ao nuk e njihnit në vitin 1999?

Gjergj Luli: Në atë kohë nuk e kam njohur; ai u prezantua si Gjeloš Krasniqi. Tani e njoh atë prej konfirmimit të aktakuzës dhe atë ditë kam dashur të them diçka por gjithçka bëhej tepër shpejt. Personi që ka ardhur në oborr në atë kohë ishte më i shkurtër dhe më i shëndoshë.

Kryetari i Trupit Gjykses: më i shëndoshë se kush?

Gjergj Luli: ... Gjeloš Krasniqi, personi që është këtu. Mund të deklaroj se ky nuk është i njëjti person.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra personi që është prezantuar si Gjeloš Krasniqi në vitin 1999 nuk është personi i pranishëm këtu?

Gjergj Luli: Jo, nuk është i njëjti.

Kryetari i Trupit Gjykses: Lidhur me uniformat e UCK-së, sepse ju thatë se personi që u prezantua si Gjelosh Krasniqi kishte të veshur një uniformë të UCK-së.

Gjergj Luli: Nuk kam thënë asnjëherë uniforma të UCK-së, kam thënë vetëm uniforma.

Kryetari i Trupit Gjykses: ...a ishin të veshur me uniforma të UCK-së?

Gjergj Luli: Jo.¹⁶

...

Prokurori Publik: Dëshiroj të lexoj atë që keni thënë para hetuesve (faqe 173). Është paragrafi i parafundit dhe sipas kësaj thuhet se kur po largoheshin nga shtëpia, Gjelosh Krasniqi ka thënë se ata do të vrisnin qenin, duke iu referuar babait tim. A ju kujtohet të keni thënë këtë hetuesve?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Si ka hyrë kjo në deklaratë?

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani nuk ju kujtohet, por a është e vërtetë se keni dëgjuar këto fjalë?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet të kem thënë këto fjalë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani që Prokurori Publik ua ka freskuar kujtesën, a ju kujtohet?

Gjergj Luli: Jo.

Avokati Mbrojtes: Ju po pyesni për faktet dhe ai i referohet deklaratës së tij.

Kryetari i Trupit Gjykses: Prokurori Publik ju ka tërhequr vëmendjen mbi deklaratën që keni dhënë para hetuesve të TPNJ-së. Në këtë deklaratë shkruhet se kur këta njerëz po largoheshin nga shtëpia, Gjelosh Krasniqi ka bërëtitur se ata do të vrisnin qenin, domethënë babain tim. Në atë kohë kjo ka qenë

¹⁶ Pjesë e nxjerrë nga procesverbali i shqyrtimit kryesor datë 11.03.2009, faqet 14 - 16

përgjigja juaj. Tani që jeni përballë gjykatës, po ju pyes përsëri, a ju kujtohet ky fakt apo jo?

Gjergj Luli: Siç thashë ai po prezantohej (ndërpritet nga gjyqtari)

Kryetari i Trupit Gjykses: Po mendoj për personin që është prezantuar si Gjelosh Krasniqi dhe ka thënë këto fjalë, pra?

Gjergj Luli: Ai nuk ka thënë këto fjalë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Atëherë si ka mundësi që në këtë deklaratë kemi një përgjigje tjetër?

Gjergj Luli: Në fillim, edhe për ato fjalët se Gega dhe Meme do të lirojnë babain tuaj, unë nuk i kam thënë ato, por pasi që Mark Luli ka përmendur fjalët se nëse Gege dhe Meme do të lirojnë babain tim, pastaj dhashë të njëjtën përgjigje si Mark Luli.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po lidhur me këto fjalët e tjera; do të vrasim qenin?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet të kem thënë këto fjalë.

Ferdinando Buatier: Por a mund të përjashtosh mundësinë t'i kesh thënë?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet të kem thënë ato fjalë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e përjashton ti kesh thënë apo jo?

Gjergj Luli: Nuk e di.

...

Prokurori Publik: E njëjta deklaratë, faqe 174, paragrafi i dytë, sipas hetuesit, ju thatë se Gjelosh Krasniqi tani banon në SHBA, e di se ka një adresë në New York dhe ai ka bërë një vizitë motrës sime Marta Ndrecaj e cila jeton në Bronx gjithashtu.' A ju kujtohet të keni thënë këtë?

Avokati Mbrojtes: ka diçka lidhur me këtë pyetje. A mund të vazhdojë gjithë fjalinë Zoti Prokuror?

Prokurori Publik: ...'Kam edhe një motër tjetër që jeton në SHBA afër Detroit në Michigan.' A ju kujtohet të keni thënë këtë hetuesve?

Gjergj Luli: Po.

Prokurori Publik: Por përpara kësaj ju keni thënë se nuk dinit asgjë për fatin e atyre që kishin marrë babain tuaj.

Gjergj Luli: Unë thashë se njerëzit në oborr nuk ishin njerëzit që jetonin në SHBA.

Prokurori Publik: Por bazuar në deklaratë ju thatë se Gjelosh Krasniqi jetonte në SHBA. Si e dini ju këtë gjë nëse nuk e njihni atë?

Gjergj Luli: Si emër, por si person nuk e kam njohur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si mund ta dini se një person emrin e të cilit ju e dini vetëm tani, jeton në SHBA?

Gjergj Luli: Kam dëgjuar nga disa njerëz se Gjelosh Krasniqi jetonte në New York SHBA.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka bërë vizitë Gjelosh Krasniqi motrës suaj apo jo?

Gjergj Luli: Nuk e di, ajo tha se ka pasur një vizitë por më vonë tha se nuk ishte e sigurtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dua të di vetëm nëse motra juaj ju tha se Gjelosh Krasniqi i kishte bërë asaj vizitë.

Gjergj Luli: Ajo ishte e pasigurtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: E pasigurtë për çfarë, personin apo vizitën?

Gjergj Luli: Personin.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse, sepse ajo njihte Gjelosh Krasniqin për pamje? Si mund të thotë ajo se a i ka bërë vizitë?

Gjergj Luli: Ajo tha, nuk e njoh atë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si mund të thotë ajo se Gjelosh Krasniqi i ka bërë asaj vizitë?

Gjergj Luli: Ka qenë i njëjti skenar si si atëherë kur i kam parë ata në oborr dhe ata bënë të njëjtën gjë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju thoni se një person i cili është prezantuar si Gjelosh Krasniqi ka bërë vizitë motrës suaj dhe se motra juaj u ka treguar për këtë vizitë të personit që ishte prezantuar si Gjelosh Krasniqi, sepse në këtë mënyrë ka kuptim. Çfarë ju ka thënë motra juaj?

Gjergj Luli: Motra ime më tha se një person kishte ardhur për t'i bërë vizitë dhe se ai ishte prezantuar si Gjelosh Krasniqi.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e ka njohur motra juaj Gjelosh Krasniqi si pamje?

Gjergj Luli: Ai nuk ka qëndruar gjatë, vetëm dy minuta.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pyetja ime ishte, a ka njohur motra juaj Gjelosh Krasniqin si pamje apo jo?

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: A ju kujohet të ju ketë telefonuar motra juaj nga New York-u dhe të ketë folur për këtë vizitën e bërë nga personi që quhej Gjelosh Krasniqi.

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Paragrafi në vijim, faqe 174; E di se kjo është thënë dhe është e dorës së dytë. Në të thuhet se motra ime në New York më ka thënë se Gjelosh Krasniqi kishte ardhur një ditë në muajin gusht në zyrën e saj të agjensisë së udëtimit që quhet Dolphin travel. Gjelosh Krasniqi ka thënë, 'Dëgjo, kam vrarë babain tënd dhe nuk ma ndin hiç për të e as për ty' dhe pastaj ai ka dalë nga zyra. A është zhvilluar kjo bisedë telefonike?

Gjergj Luli: Jo, nuk e kam thënë këtë.

Prokurori Publik: Por ju e keni nënshkruar?

Gjergj Luli: Po.

Prokurori Publik: Pse e keni bërë këtë?

Gjergj Luli: Sepse nuk përmendeshin fjalët, Unë e kam vrarë.

Prokurori Publik: Do të thoni se deklarata është ndryshuar pasi që ju e keni nënshkruar?

Gjergj Luli: Nuk e di.

Prokurori Publik: Pas luftës, a e keni takuar personin që është prezantuar si Gjelosh Krasniqi?

Gjergj Luli: Jo.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Dua të di; meqënëse kjo deklaratë përmban dy data, 25 shkurt dhe 2 mars; tani ju pyes, si ka shkuar intervista? Ju jeni marrë në pyetje me datë 25 dhe pastaj me datë 2 mars oficeri i policisë ju ka lexuar versionin shqip të deklaratës?

Gjergj Luli: Nuk më është lexuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Me datë 2 mars 2004 ju keni nënshkruar se kjo deklaratë ju është lexuar në shqip; pra kjo është deklaruar nga ju por meqënëse kemi dy data, gjëja më e mundshme për t'u menduar është se me datë 25 keni dhënë deklaratën dhe pastaj është vënë me shkrim dhe ju është lexuar në shqip me datë 2 mars 2004. A është e mundur?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqënëse keni nënshkruar me 2 mars.

Gjergj Luli: E kam nënshkruar por askush nuk m'a ka lexuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Atëherë pse e ke nënshkruar atë?

Gjergj Luli: Atë ditë më morën mostra gjaku.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thatë se me datë 25 ju keni dhënë deklaratë dhe me datë 2 mars një hetues ka ardhur nga TPNJ-ja në shtëpinë e këtij personit tjetër për të marrë mostra gjaku?

Gjergj Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Me datë 2 mars keni nënshkruar deklaratën?

Gjergj Luli: Kam nënshkruar me datë 2 mars por nuk më është lexuar. Askush nuk ka ardhur tek unë, unë kam shkuar në Prishtinë. Jo në shtëpinë e tij siç e përmendët ju por në Prishtinë.

...

Prokurori Publik: Duke iu kthyer kësaj deklaratë ku ju keni shkuar tek TPNJ-ja për të kërkuar babain tuaj. Dëshiroj të ju ballafaqoj me faqen 167 paragrafi 3, ju keni thënë hetuesit: "Kam ardhur tani në mënyrë spontane në zyrën e TPNJ-së në Prishtinë me vullnetin tim që të kërkoj prova për babain tim. Kur jam intervistuar në janar 2003, kisha frikë të spjegoj gjithçka. Nuk kam guxuar të jap dy emrat që ishin të përfshirë në rrëmbimin e babait por tani dua të shtoj këtë informacion."

Siç e lexova në këtë deklaratë, ju nuk keni shkuar vetëm për babain tuaj por edhe për të shtuar diçka deklaratës suaj.

Gjergj Luli: Lidhur me këta dy njerëz që nuk kam përmendur asnjëherë, nëse doni të më ballafaqoni, më thoni emrat.

Prokurori Publik: Paragrafi 4, 'emrat që nuk kam guxuar të konfirmoj ishin Lahi Ibrahimaj dhe Malik Ndrecaj. I pari ishte nga Jabllanica dhe tjetri nga Klina'. Këta ishin emrat që ju nuk keni dhënë në deklaratën e parë dhe pastaj i keni dhënë në deklaratën e dytë.

Gjergj Luli: Nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Por ju e keni shkruar deklaratën.

Gjergj Luli: Këtë nuk e kam përmendur kurrë. Gjithçka tjetër është e shkruar por kjo nuk është...

Kryetari i Trupit Gjykses: ... Pra ju thatë se nuk keni thënë kurrë këta emra?

Gjergj Luli: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, TPNJ-ja i ka shpikur këto gjëra sepse ata i kanë shkruar këta dy emra?

Gjergj Luli: Nuk e di. Nuk i kam përmendur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Por kini parasysh se keni nënshkruar.

Gjergj Luli: Po, e kam nënshkruar por nuk kam përmendur emra.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në paragrafin 4 ju keni thënë diçka më të saktë 'kam njohur Lahi Ibrahimaj dhe Maliq Ndrecaj nga Gjelosh Krasniqi i cili ishte ai që identifikova si njëri nga rrëmbyesit e babait tim - kam marrë këtë informatë rreth 4 muaj pas luftës - kur rastësisht takova Gjelosh Krasniqin në fshatin Doblibare. E pashë atë në rrugë në fshatin tim dhe iu afrova për t'a pyetur mbi vendndodhjen e babait tim.'

Avokati Mbrojtes: Lidhur më atë që lexuat, i nderuari Kryetar, po lexoj tani; takova Gjelosh Krasniqin në shtëpinë time në fshatin Doblibare, kjo është në kundërshtim me deklaratën time të mëparshme. A ishte ai në fshat apo në shtëpinë e tij? Gjithashtu në pikën 7, kemi një kundërshtim tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të shohim fillimisht pjesën më të rëndësishme dhe pastaj vazhdojmë. Këtu, ju keni thënë se keni dëgjuar emrat nga Gjelosh Krasniqi 'ai të cilin e identifikoj si njëri nga rrëmbyesit e babait tim.'
Çfarë thoni tani?

Gjergj Luli: Gjërat e shkruara këtu, se kam takuar Gjelosh Krasniqin në shtëpinë time, nuk është e vërtetë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dua të di nëse keni dëgjuar këta emra nga Gjelosh Krasniqi?

Gjergj Luli: Kam takuar në fshat një person që quhej Gjelosh Krasniqi por nuk është i njëjti person me atë që është tani në gjykatë.

Ferdinando Buatier: Personi që ka rrëmbyer babain tuaj?

Gjergj Luli: Po, dhe gjërat se unë kam takuar Gjelosh Krasniqin nuk janë të vërteta, nuk kam thënë asnjëherë këtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në fshatin tim të lindjes jo në fshatin tim.

Gjergj Luli: Thashë shtëpi por tani e bëj të qartë se bëhet fjalë për fshat.

Prokurori Publik: Në paragrafin 5, thuhet se Gjelosh Krasniqi ka thënë se 'çfarë ka ndodhur babait tim duhet të shkoj në Shtabin e Përgjithshëm të UCK-së në Jabllanicë dhe të flas me Lahi Ibrahimaj dhe Maliq Ndreca. Gjelosh Krasniqi më tha se ai kishte shoqëruar babain tim në fshatin Maznik.'

Paragrafi 7, 'kur ka ndodhur rrëmbimi i babait tim ishte errësirë dhe kam mundur të identifikoj vetëm Gjelosh Krasniqin si njëri nga rrëmbyesit.' A ju kujtohet të keni deklaruar këtë njërit nga hetuesit?

Gjergj Luli: Bazuar në emrin, kam thënë këtë.

Prokurori Publik: Ai që përmendët Gjelosh Krasniqi, nuk është Gjelosh Krasniqi që gjendet sot këtu?

Gjergj Luli: Jo, nuk është.¹⁷

...

Prokurori Publik: Nëse shkojmë në nëndosjen 28, faqja

¹⁷ Pjesë nga procesverbali i shqyrtimit kryesor datë 11.03.2009, faqet 23 – 25

154, deklarata e datës 16 janar 2008, tani faqja 155 dhe paragrafi që fillon me "Takova", pak më poshtë se në mes, thuhet, sipas kësaj, ju keni thënë një hetuesi, hetues i UNMIK-ut "Takova Gjeloš Krasniqin 4 ditë pas luftës, të martën në Doblibare në shtëpinë e Pashk Lulit, djali i tij Gjeloši doli jashtë dhe i tha që t'a thërrasë. Gjeloši doli jashtë dhe tha çfarë don? Unë e pyeta se ku ishte babai im.' 'Gjeloš tha "e kam lënë në fshatin Maznik", komuna e Pejës dhe mos u mundo t'a kërkosh se mund të humbasësh edhe ti si babai yt". E pyeta pse dhe ai tha largohu se do t'a bëj këtë fshat shkumb e hi dhe mbylli derën dhe unë u ktheva në shtëpi.'

Kryetari i Trupit Gjykses: Kini parasysh se kjo deklaratë nuk është dhënë para hetuesit të TPNJ-së. Ne kemi versionin në shqip dhe përkthimin në anglisht. Pra ju keni nënshkruar versionin original në shqip. Kini shumë kujdes kur të përgjigjeni dhe Prokurori Publik po ju ballafaqon duke u bazuar në një deklaratë tjetër, cila është përgjigja juaj sepse në këtë deklaratë është pak a shumë e njëjta gjë me atë që keni thënë hetuesit të TPNJ-së dhe përsëri po ju paralajmëroj se nëse nuk thoni të vërtetën kjo përbën vepër penale.

Gjergj Luli: Përgjigja ime e parë është se ne jemi takuar në fshat.

Kryetari i Trupit Gjykses: Duam të ju dëgjojmë përsëri, vazhdoni.

Gjergj Luli: Nuk kam asgjë për të shtuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: 16 janar 2008, a qëndroni pranë kësaj deklarate?

Gjergj Luli: Po, kjo është deklarata ime.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju i qëndroni asaj?

Gjergj Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur keni kuptuar se Gjeloš Krasniqi nuk është i njëjti?

Gjergj Luli: Ditën e konfirmimit të aktakuzës.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishit i pranishëm?

Gjergj Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse nuk keni thënë asgjë?

Gjergj Luli: Sepse krejt papritmas ata thanë se seanca kishte përfunduar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju qëndroni pranë deklaratës së dhënë me datë 16 janar.

Gjergj Luli: Po.

Prokurori Publik: Dëshiroj të vazhdoj me këtë deklaratë sepse në të thuhet se 'Gjelosh Krasniqi është larguar nga Kosova për në SHBA - motra ime Marta Ndrecaj, e cila jeton në New York dhe punon në një agjensi udhëtimi - Gjelosh Krasniqi ka shkuar në zyrën e motrës sime dhe i ka thënë se babai ynë është i varrosur afër shtëpisë. Motra ime më telefonoi dhe tha se babai ynë ishte afër shtëpisë.'

Juu treguat hetuesve lidhur me bisedën që keni pasur me motrën tuaj. A është ky Gjelosh Krasniqi që ju keni takuar këtu apo që ju keni shpikur?

Gjergj Luli: Nuk mund të flas në emër të motrës sime, por ky i akuzuar nuk i njëjti me atë për të cilin kam folur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cili Gjelosh Krasniqi ka shkuar në SHBA, ai që është këtu apo ai që sipas versionit tuaj ka rrëmbyer babain tuaj?

Gjergj Luli: Nuk e di cili është larguar nga Kosova por thashë se ai djali që quhej Gjelosh Krasniqi është larguar dhe ka shkuar në SHBA.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe pastaj keni biseduar me motrën tuaj dhe ajo ju ka thënë se ai i kishte bërë asaj një vizitë? A është e saktë?

Gjergj Luli: Ai është prezantuar si Gjelosh Krasniqi, ajo nuk e njeh atë djalë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ky djalë, që prezantohet si

Gjelosh Krasniqi, ka thënë diçka lidhur me fatin e babait tuaj; ai dinte vendin ku është varrosur babai juaj.

Gjergj Luli: Po.

Ballafaqimi lidhur me kërcënimet e raportuara nga shoku i të Pandehurit të Parë.

Prokurori Publik: A ju ka kërcënuar dikush pas luftës që ju të tërhiqeni nga kjo lëndë?

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: A keni dëgjuar për një kërcënim të lidhur me emrin tuaj?

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: Nënparagrafi 27, faqe 149, deklaratë e dhënë me datë 1 mars 2008 hetuesve të UNMIK-ut, oficeri Hazbi, ju keni dhënë deklaratën në vijim: 'një shok i imi i cili ishte duke pirë me Gjelosh Krasniqin tha se Gjelosh Krasniqi nuk ndihej shumë i lirë tani që djemtë e Pashkut janë rritur.' Dhe përgjigja e tij ishte 'Do t'a vras njësoj si babain e tij dhe do t'a zhduk si babain e tij' dhe shoku im më informoi për këtë në telefon dhe kërkoi që të mos përmendej emri i tij për arsye sigurie për të dhe familjen e tij. Unë dhe familja ime kemi frikë nga Gjelosh Krasniqi sepse ai është person shumë i rrezikshëm.' A ju kujtohet kjo?

Gjergj Luli: Nuk kam thënë se kemi frikë.

Prokurori Publik: Pyetja ime ishte, a ju kujtohet të keni thënë këtë hetuesve të UNMIK-ut?

Gjergj Luli: Kam dhënë këtë deklaratë.

Prokurori Publik: Por sot po thoni se jeni kërcënuar nga një person i tretë.

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: Tani nuk kuptoj.

Kryetari i Trupit Gjykses: Këtu është e shkruar se 'Kam frikë nga Gjesh Krasniqi sepse ai është shumë i rrezikshmë. Pse kishit frikë?

Gjergj Luli: Nuk kam thënë këtë asnjëherë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thatë këtë para 10 minutash, këtu nuk jemi mes shokësh, kjo është gjykatë.

...

Gjergj Luli: Por, asnjëherë nuk kam thënë se kisha frikë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por ju keni nënshkruar dhe është në shqip.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po lidhur me fjalët e cituara nga Prokurori Publik: "Do t'a vras siç kam vrarë babain e tij". Duket si kërcënim.

Avokati Mbrojtes: Këto nuk janë fjalë të thëna nga dëshmitari por ju lutem lexoni citatet e plota dhe mos i ndërpritni ato.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në rregull por gjithsesi nuk mendoj se ndryshon kuptimi, do ta lexoj. 'Do t'a vras në të njëjtën mënyrë siç kam vrarë babain e tij dhe do t'a zhduk siç kam zhdukur babain e tij.'

Gjergj Luli: Ky nuk është kërcënim vetëm nëse dikush vjen tek dera e shtëpisë sime.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nuk jemi këtu për të dhënë përkufizimin e fjalës kërcënim; Jemi këtu për të ditur nëse ky shoku juaj ka treguar fjalët e thëna nga Gjesh Krasniqi.

Gjergj Luli: Kështu më kanë thënë.¹⁸

...

¹⁸ Pjesë nga procesverbali i shqyrtimit kryesor datë 11.03.2009, faqet 27 – 28

Prokurori Publik: Po kaloj në deklaratën tjetër. Nëndosja 26, dhe është një deklaratë e dhënë me datë 26 gusht 2008, paragrafi i parë ku thuhet; prej fillimit kur babai im është marrë me 24 mars 1999, pastaj ju nuk keni lëvizuar nga shtëpia për dy orë, "ne ishim në oborrin e xhaxhait tim, Nikollë Luli, kur Gjelosh Krasniqi ka kapur babain tim për krahu dhe ndërsa ata ishin duke dalë nga dera unë dhe xhaxhai im Mark Luli ishim afër derës. Rreth orës 23:00, Gjelosh Krasniqi bashkë me katër shokë të tij doli nga oborri i xhaxhait tim dhe unë shkova pas tyre për të parë se ku po dërgonin babain tim. Pasi që dola nga dera, dola përsëri por kur Gjelosh Krasniqi më pa duke hapur derën ai m'u drejtua me këto fjalë: 'mbylle derën përndryshe do t'a vras si qen.' Pastaj mbylla derën dhe nuk dola më jashtë.'

A ju kujtohet të keni thënë këtë hetuesit të UNMIK-ut?

Gjergj Luli: E kam thënë por nuk kam përmendur asnjë emër. Ata thanë; mbylle derën dhe qëndro aty edhe 2 orë.

Prokurori Publik: Pra kur hetuesi ka vënë emrin e Gjelosh Krasniqit, e kanë shpikur atë?

Gjergj Luli: Unë po them se asnjëherë nuk e kam thënë atë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kemi këtë versionin në shqip me emrin e Gjelosh Krasniqit, emri gjendet dy herë në versionin shqip. Si ka mundësi?

Gjergj Luli: Unë kam thënë se njëri prej tyre është kthyer dhe ka thënë "mbylle derën".

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por ju e keni nënshkruar atë, ju e thatë. Është ndryshe. Pra mohoni se ju e keni përmendur emrin e Gjelosh Krasniqit?

Gjergj Luli: Atë moment po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në versionin anglisht, rreshti i dytë, është Gjelosh Krasniqi dhe përsëri në rreshtin e tretë nga fundi.

Avokati Mbrojtës: Ju po pyesni për disa rrethana.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por rreshti i parë është i qartë (rreshti i lexohet Avokatit Mbrojtës). Është shkruar mirë në gjuhën shqipe dhe mendoj se kjo është e padiskutueshme. Ju insistoni se emri dhe mbiemri i Gjelos Krasniqi nuk është përmendur?

Gjergj Luli: Në momentin kur ai u kthye nga dera unë nuk e thashë emrin e tij.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte ky Gjelos Krasniqi njëri prej të 4-ve që urdhëroi të mos largoheshit nga shtëpia për 2 orë?

Gjergj Luli: Ai u prezantua si Gjelos Krasniqi por nuk ishte personi që më urdhëroi të mos lëvizja nga shtëpia për dy orët në vazhdim.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ky person që u prezantua si Gjelos Krasniqi ishte me 4 persona të tjerë por nuk u urdhëroi që të qëndronit në shtëpi për 2 orë, është e saktë apo jo?

Gjergj Luli: Po, për sa më përket mua.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po për sa i përket personit tjetër i cili tha 'mbylle derën përndryshe do t'a vras babain e tij si qen', a ishte ai Gjelos Krasniqi apo një person tjetër?

Gjergj Luli: Një person tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në rregull, kjo është përgjigja juaj. Pse keni deklaruar në versionin shqip se ju nuk i keni dëgjuar kurrë këto fjalë?

Gjergj Luli: Ato që kam thënë i pranoj por nuk mund të them asgjë për gjëra që nuk i kam thënë kurrë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por ju e keni nënshkruar atë dhe kjo do të thotë se ju e keni thënë këtë.

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet t'i kem thënë këto fjalë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por një vit më parë ju i keni thënë këto fjalë dhe ju keni firmosur në secilën faqe.

Prokurori Publik: Zhdukja e babait tuaj më datë 24 mars 1999; a ka patur një impakt të madh tek ju kjo?

Gjergj Luli: Sigurisht.

Prokurori Publik: Deklarata e parë në polici në 2003 dhe aty keni thënë, ju e dinit me siguri se ishte i pandehuri i cili erdhi në shtëpinë tuaj atë mbrëmje, sepse ju e njihnit atë që më parë dhe tani ju doni që ne t'u besojmë se nuk u kujtohet asgjë përveç faktit se ai quhej Gjelosh Krasniqi?

Gjergj Luli: Unë mund të them vetëm se ai u prezantua si Gjelosh Krasniqi, por unë nuk njihja asnjëri me atë emër më parë.

...

Ballafaqimi në lidhje me faktin se më datë 7 tetor 2008, i Pandehuri i Parë i ka tërhequr të gjitha akuzat kundër Gjelosh Krasniqit:

Kryetari i Trupit Gjykses: Nuk mund të mohohet fakti se më datë 7 tetor 2008 ju keni dhënë deklaratë në polici.

Prokurori Publik: Kjo ishte deklarata e fundit që ju keni dhënë në lidhje me këtë lëndë. Ju kujtohet se pse shkuat atje kur dhatë deklaratën e fundit?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Do t'ua freskoj kujtesën. Në faqen 134, është pyetja se pse keni ardhur sot këtu dhe përgjigja ishte se ju kishit shkuar për të tërhequr akuzat kundër Gjelosh Krasniqit. Ju kujtohet kjo?

Gjergj Luli: Po.

Prokurori Publik: Ju kujtohet se pse shkuat në polici, cila ishte arsyeja që donit të tërhiqnit akuzat?

Gjergj Luli: Më kujtohet tani. Arsyeja për të cilën e bëra atë bazohet në emrin e tij sepse në atë kohë nuk

e njihja atë dhe ata thanë se ai ishte liruar nga burgu, sepse në atë kohë unë nuk e njihja atë. Kur dëgjova se ai ishte liruar shkova të pyes Kelly dhe Hazbiun mbi arsyen se pse ai ishte liruar dhe ata më thanë se nuk e dinin dhe se ai ishte liruar me urdhër të gjykatës. Unë thashë pastaj se nëse ai ishte liruar nga gjykata atëherë edhe unë mund t'a bëj këtë. Kjo ishte; Kelly dhe Hazbiu më thanë se ai ishte liruar nga prokuroria dhe gjykata. Pastaj unë thashë se nëse ata e kanë liruar ai është i pafajshëm; por më duhet të theksoj se në atë kohë nuk e njihja atë si fytyrë.

Prokurori Publik: Por ju po merreni me dy Gjelosh Krasniqi? Ju thatë se ju njihnit si emër vetëm atë i cili erdhi në shtëpinë tuaj dhe ju njihnit një Gjelosh Krasniqi i cili ishte arrestuar nga policia. Pse donit të tërhiqnit akuzat kundër dikujt për të cilin ju mendonit se i kishte bërë diçka babait tuaj?

Gjergj Luli: Nuk e njihja atë, por prokuroria vendosi që t'a lironte atë pavarësisht nëse ai ishte një nga personat i cili erdhi atë natë. Pra meqënëse ai ishte liruar nga gjykata dhe prokuroria edhe unë i tërhoqa akuzat pa marrë parasysh nëse ai ishte ai person apo dikush tjetër.

...

Prokurori Publik: Në vijim, rreshti 3, ku thuhet pse, dhe përgjigja ishte se pas konsultimit me anëtarët e familjes dhe të afërmit vendosa të tërheq akuzat sepse babai kishte veshur uniformën e gabuar të policisë serbe. Kjo nuk ishte përgjigja që ju dhatë më parë.

...

Gjergj Luli: Është e vërtetë. Bisedova me familjen për këtë kur ai u lirua nga burgu.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cila ishte arsyeja e vërtetë; ajo sepse babai juaj kishte veshur uniformën e gabuar apo për arsye se gjykata e kishte liruar atë?

Gjergj Luli: Unë dëgjova se personi i cili e prezantoi veten si Gjelosh Krasniqi ishte liruar nga burgu. Këtë e diskutova me familjen dhe më pas bisedova me Kelly dhe Hazbiun dhe pasi ata më thanë se ai ishte liruar

nga prokuroria dhe gjykata dhe pasi bisedova me familjen, familja ime tha se ai është i pafajshëm dhe më tha të shkoja të jepja deklaratë sepse nëse gjykata dhe prokuroria e ka liruar, për ne ai është i pafajshëm.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është përgjigja që ju dhatë në fillim të deklaratës tuaj, por Prokurori Publik ua përkujtoi faktin se në polici ju nuk keni dhënë këtë arsye, por se ju keni thënë vetëm se kjo ishte sepse babai juaj kishte veshur uniformën e gabuar të policisë serbe.

Gjergj Luli: Arsyja e vërtetë ishte sepse ai ishte liruar nga prokuroria dhe gjykata dhe gjithashtu sepse ai kishte veshur uniformën e gabuar. E para është më e rëndësishmja.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse nuk e thatë në polici arsyen më të rëndësishme? Përkundrazi ju iu referuat arsyes më të parëndësishme; kjo është sjellje e çuditshme, apo jo?

Gjergj Luli: Unë deklaroja arsyen se ai ishte liruar nga gjykata dhe prokuroria por e përmenda edhe uniformën.¹⁹

Ballafaqim në lidhje me Mercedes 320 i cili pretendohet të jetë vozitur nga Gjeloš Krasniqi:

Prokurori Publik: Dëshiroj të vazhdoj me të njëjtën deklaratë. Për më tepër, fjalia e cila fillon me 'pastaj ai erdhi', është paragrafi i gjatë, ku thuhet: 'Pastaj ai erdhi (ai është Gjeloš Krasniqi) në Kosovë dhe voziste një Mercedes 320, me targa të New York-ut, pastaj, ai shkoi në Kroaci, dhe sipas informacionit që kam ai shkoi në Kroaci për të ndryshuar identitetin e tij (emrin dhe mbiemrin) por nuk pati sukses. Pasi u kthye nga Kroacia, ai ndenji disa javë në Kosovë dhe pastaj shkoi në Shqipëri dhe u kthye me një BMW me targa shqiptare.'

Gjergj Luli: Mua më thanë se ai kishte shkuar në Shqipëri por nuk e kam parë atë.

¹⁹ Pjesa është nxjerrë nga Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të dates 11.03.2009, faqet 32 – 33

Prokurori Publik: Si ka mundësi që disa u thanë se ai ishte kthyer me një Mercedes me targa New York?

Gjergj Luli: Sepse ata e panë.

Prokurori Publik: Kush janë ata?

Gjergj Luli: Aty ka disa persona dhe ndoshta ata e njohën.

Prokurori Publik: Kush janë 'ata? 'Emrat?'

Gjergj Luli: Disa nga njerëzit e mi.

Prokurori Publik: Emrat?

...

Gjergj Luli: Nuk mund të jap informata.

Ballafaqimi përsa i përket takimit mes të Pandehurit të Parë dhe Gjeloš Krasniqit në Gjakovë pas luftës:

Ferdinando Buatier: Të kthehemi në të dyshuarin e tanishëm në seancën e sotshme. Ju thatë se për herë të parë e patë atë në seancën e konfirmimit?

Gjergj Luli: Po.

Ferdinando Buatier: Në deklaratën tuaj para Policisë Ndërkombëtare të UNMIK-ut në tetor 2008, faqja 135, ju i keni thënë hetuesit se ju e keni akuzuar atë sepse ju e kishit parë duke lëvizur në Gjakovë. Kjo është deklarata juaj dhënë më datë 7 tetor. Cilit person i referoheni; të dyshuarit aktual, atij i cili u mori babain apo të dyve?

Gjergj Luli: Personit të cilin e pashë atë natë kur ata erdhën në shtëpinë time. Më vonë, pas luftës e takova në fshat.

Ferdinando Buatier: Pse keni thënë më datë 7 tetor 2008 se ju e keni akuzuar atë për arsye se e keni parë në Gjakovë. Kjo është ajo që keni thënë; e pashë duke lëvizur në Gjakovë dhe e akuzova.

Gjergj Luli: Nuk kam thënë se e pashë. Kam thënë vetëm se ai po lëvizte përreth.

Ferdinando Buatier: Nuk është kjo të cilën keni nënshkruar dhe nuk është kjo që shkruhet në deklaratën tuaj.

Gjergj Luli: Nuk e kam parë atë, sepse atë ditë kam punuar gjithë ditën.²⁰

1.8 Përmbledhje

I Pandehuri i Parë nuk ka dhënë dëshmi në shqyrtimin e tij kryesor, përveç për të deklaruar se dëshmia e tij dhënë më datë 11 mars 2009 ishte e vërtetë.

Trupi Gjykues gjen se ka kontradikta të qarta dhe të pamohueshme mes asaj që i Pandehuri i Parë ka deklaruar në Gjykatë më datë 11 mars 2009 dhe asaj që u ka thënë hetuesve në deklaratat e tij paraprake.

I Pandehuri i Parë ka dëshmuar se më datë 24 mars 1999 ai ishte në oborrin e shtëpisë së xhaxhait të tij, Mark Luli së bashku me babain e tij Pashk Luli, Prenk Luli, Engjell Luli dhe Bekim Luli.

Kur dha dëshmi përpara Trupit Gjykues i Pandehuri i Parë deklaroi se ai ishte në shtëpinë e xhaxhait të tij, Mark Luli. Në deklaratën që ai dha para hetuesve të TPNJ-së më datë 18 janar 2003 i Pandehuri i Parë deklaroi se kishte qenë në "shtëpinë e babait në Doblibare". Në deklaratën e dhënë para hetueve të TPNJ-së më datë 2 mars 2004, duke iu referuar babait të tij, i Pandehuri i Parë deklaroi se ai ishte rrëmbyer nga shtëpia e "tij". Në deklaratën e tij dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 16 janar 2008 i Pandehuri i Parë i referohet Gjelojsh Krasniqit si personi që hyri në oborrin e "shtëpisë së xhaxhait". Ai jep emrin e xhaxhait të tij Nikolle Luli. Në deklaratën e tij dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 26 gusht 2008 i Pandehuri i Parë thotë se ka qenë në oborrin e xhaxhait të tij, Nikolle.

²⁰ Pjesë e nxjerrë nga Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të dates 11.03.2009, faqet 39 – 40

Kur ata ishin në oborr, pesë ushtarë u futën në lokal dhe bënë pyetje mbi babain e të Pandehurit të Parë. Këta persona ishin të armatosur.

Në deklaratën e tij dhënë para hetuesve të TPNJ-së më datë 18 janar 2003 i Pandehuri i Parë deklaroi se ushtarët ishin futur në oborr në orën 20.30. Në deklaratën e dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 16 janar 2008 ai dha kohën si afërsisht ora 20.15.

I pandehuri i Parë dëshmoi se ishte errësirë dhe se ai nuk mund t'i shihte uniformat. Kjo ka qenë në kontradiktë me deklaratën e dhënë më datë 18 janar 2003 para hetueve TPNJ-së, dhe deklaratën e dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 16 janar 2008. Në të dyja deklaratat i Pandehuri i Parë ka thënë se ushtarët kishin veshur uniforma kamuflazhi të gjelbra.

I pandehuri i Parë dëshmoi se nuk ka parë ndonjë emblemë ushtarake. Kjo është në kontradiktë me deklaratën që ai ka dhënë para hetuesve të TPNJ-së më datë 18 janar 2003. Në atë deklaratë ai ka thënë se ushtarët kishin emblema të UÇK-së të vendosura në mëngë. Megjithatë, gjatë deklaratës së tij të datës 18 janar 2008, në referencë të 24 marsit 1999, i Pandehuri i Parë ka thënë se Gjeloš Krasniqi kishte veshur uniformë kamuflazhi pa emblemat e UÇK-së.

Babai i të Pandehurit të Parë u prezantua. Atij iu konfiskuan armët dhe u udhëzua që të shkonte me personat në uniformë. Ata u larguan bashkë. I pandehuri i Parë dëshmoi se rreth 2 - 2 ½ orë më vonë personat në uniformë u kthyen me babain e tij. Pastaj ushtarët u larguan përsëri duke e marrë me vete babain e të Pandehurit të Parë. Babai i të Pandehurit të Parë nuk u pa më kurrë.

I pandehuri i Parë dëshmoi se nuk njihte asnjë prej pesë ushtarëve. Ishte dëshmia e tij se një nga ushtarët thjesht prezantoi veten si Gjeloš Krasniqi por se ai nuk e njihte atë. Kjo kundërshton deklaratat e tij të mëparshme.

Në deklaratën e tij dhënë para hetuesve të TPNJ-së më datë 18 janar 2003, i Pandehuri i Parë ka deklaruar se ai njihte një nga ushtarët dhe se ai ishte prezantuar si Gjeloš Krasniqi. Ai tha se e njihte këtë person nga fshati Nepole, komuna e Pejës. Nuk kundërshtohet fakti se Gjeloš Krasniqi ka lindur në fshatin Nepole dhe se ai aktualisht banon aty.

Gjatë asaj deklarate i Pandehuri i Parë iu referua gjithashtu një takimi në New York në gusht 2002 mes Gjelosh Krasniqit dhe motrës së tij Marta Nrecaj.

Në këtë deklaratë para hetuesve të TPNJ-së më datë 2 mars 2004, i Pandehuri i Parë ka deklaruar se ai kishte frikë të zbulonte emrat e dy personave të tjerë të cilët mund të ishin të përfshirë në rrëmbimin e babait të tij. Ai ka thënë se ai i kishte zbuluar këta emra nga Gjelosh Krasniqi, të cilin e ka identifikuar si rrëmbyesin e babait të tij, kur ai e kishte takuar në Doblibare.

Më tej i Pandehuri i Parë ka deklaruar se natën kur babai i tij ishte marrë kishte qenë errësirë dhe se ai kishte mundur të identifikonte vetëm Gjelosh Krasniqin.

Në deklaratën e tij dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 16 janar 2008, i Pandehuri i Parë ka folur mbi një incident në 1998 kur Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, komuna e Pejës, së bashku me tre persona të tjerë, kishte vjedhur një Mercedes 190, pronë e Pal Ndrecajt.

Në atë deklaratë, duke iu referuar ngjarjeve të 24 Marsit 1999, i Pandehuri i Parë ka deklaruar se rreth orës 20.30 të mbrëmjes Gjelosh Krasniqi dhe personat e tjerë ishin futur në oborrin e shtëpisë.

Më tej i Pandehuri i Parë ka deklaruar se katër ditë pas luftës ai kishte takuar Gjelosh Krasniqin në shtëpinë e Pashk Pergegës në fshatin Doblibare. I Pandehuri i Parë i kishte kërkuar Robert Pergegës që të thërriste Gjelosh Krasniqin dhe t'a pyeste atë se ku e kishte lënë babain e tij.

I Pandehuri i Parë ka deklaruar se Gjelosh Krasniqi e kishte informuar se ai e kishte lënë babain e tij në fshatin Maznik, se ai nuk dinte asgjë për atë dhe se ai nuk duhej të lodhej të kërkonte babain e tij përndryshe ai mund të humbiste si babai i tij. I Pandehuri i Parë ka deklaruar se kur u pyet se pse, Gjelosh Krasniqi është përgjigjur se ai duhej të largohej përndryshe do t'a bënte fshatin "shkrumb e hi".

Në atë deklaratë i Pandehuri i Parë përsëri ka përmendur takimin në New York mes Gjelosh Krasniqit dhe motrës së Pandehurit të Parë.

Në deklaratën e tij dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 1 mars 2008 i Pandehuri i Parë ka deklaruar se më datë 20 shkurt 2008 ai kishte thirrur punonjësin e policisë Hazbi Axhamin me qëllim që t'a informonte atë në lidhje me disa kërcënime që kishte marrë. Ai ka deklaruar se ai dhe familja e tij ishin të frikësuar nga Gjelosh Krasniqi sepse ai është shumë i rrezikshëm.

Në deklaratën e tij para policisë së UNMIK-ut më datë 26 gusht 2008 i Pandehuri i Parë përsëri iu referua ngjarjeve të 24 marsit 1999. I Pandehuri i Parë deklaroi se më datë 6 gusht 2008 Pal Krasniqi kishte shkuar tek i Pandehuri i Parë dhe i kishte kërkuar atij "të ndihmonte Gjelosh Kasniqin dhe të tërhiqte akuzat kundër tij, sepse ai nuk ka të bëjë me vrasjen e Pashkut".

Më së fundi, më deklaratën e tij dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 7 tetor 2008 i Pandehuri i Parë ka deklaruar se donte të tërhiqte akuzat kundër Gjelosh Krasniqit. I Pandehuri i Parë ka deklaruar se ai nuk kishte genë i kërcënuar dhe se, megjithëse kishte parë më parë Gjelosh Krasniqin duke u sjellë përreth Gjakovës dhe e kishte akuzuar atë, tani ai donte të tërhiqte të gjitha akuzat.

Trupi Gjykues gjen se mospërputhjet mes deklaratave të mëparshme të të Pandehurit të Parë dhe dëshmisë së tij në Gjykatë më datë 11 mars 2009 nuk mund të spjegohen vetëm në bazë të faktit se i Pandehuri i Parë po dëshmonte në lidhje me ngjarje të ndodhura rreth dhjetë vjet më parë. Dhe vërtet, i Pandehuri i Parë nuk ka pohuar kurrë se kujtesa e tij mbi ngjarjet e natës kritike është dobësuar nga vitet që kanë kaluar.

I Pandehuri i Parë nuk e ka mohuar faktin se i ka firmosur deklaratat e tij të mëparshme.

Deklaratat të cilat i Pandehuri i Parë ka dhënë para hetuesve të TPNJ-së më datë 18 janar dhe 2 mars 2003 janë regjistruar në gjuhën angleze. I Pandehuri i Parë ka deklaruar se deklaratat nuk i janë lexuar në gjuhën shqipe. Më tej, ai ka sfiduar saktësinë e këtyre deklaratave.

Të dyja deklaratat e TPNJ-së përmbajnë një deklaratë në gjuhën angleze se deklaratat respektive i janë lexuar të Pandehurit të Parë në gjuhën shqipe. Dhe vërtet, gjatë shqyrtimit kryesor të Gjelosh Krasniqit, Trupi Gjykues ftoi

Emir Shehun, përkthyes i certifikuar i gjuhës shqipe pranë TPNJ-së, i cili dëshmoi se i kishte lexuar të Pandehurit të Parë deklaratën e tij të 2 marsit 2004 në gjuhën shqipe.

Përkthyesi i cili, pretendohet, se i kishte lexuar të Pandehurit të Parë deklaratën e tij dhënë para hetuesve të TPNJ-së më datë 18 janar 2003 nuk ka dëshmuar gjatë shqyrtimit kryesor të Gjeloš Krasniqit.

Deklaratat të cilat i Pandehuri i Parë ka dhënë para policisë së UNMIK-ut janë shkruar në gjuhën shqipe. Ato deklarata, nga të gjitha pikëpamjet materiale, përputheshin me deklaratat të cilat i Pandehuri i Parë ka dhënë para hetueve të TPNJ-së.

Trupi Gjykses gjen se dëshmia, të cilën i Pandehuri i Parë ka dhënë para Trupit Gjykses më datë 11 mars 2009, është e rreme. Nga aspekte të ndryshme materiale, dëshmia e tij është në kontradiktë me deklaratat e tij të mëparshme. Në veçanti, i Pandehuri i Parë ka dëshmuar se më datë 24 mars 1999 ai thjesht nuk e njihte Gjeloš Krasniqin. Ai tha se dikush thjesht u prezantua si Gjeloš Krasniqi. Ajo ishte gënjeshtër. Është e qartë nga deklaratat e tij të mëparshme se ai e njihte Gjeloš Krasniqin të paktën nga viti 1998.

Trupi Gjykses gjen se i Pandehuri i Parë ka dhënë dëshmi të rreme kur ai ka dëshmuar para Trupit Gjykses më datë 11 March 2009 në lëndën kundër Gjeloš Krasniqit.

Dhënia e dëshmisë së rreme para Trupit Gjykses përbën vepër të rëndë penale. Personave, të cilët dënohen për dhënie dëshmie të rreme mund t'u shqiptohet zakonisht një dënim i gjatë me burg. Megjithëse i Pandehuri i Parë e ka mohuar faktin se ka qenë i kërcënuar, Trupi Gjykses gjen se nëse ai nuk është kërcënuar drejtpërdrejt ai ka qenë, të paktën, shumë i frikësuar nga Gjeloš Krasniqi dhe ka pasur frikë për sigurinë e tij personale dhe atë të anëtarëve të familjes. Duke marrë parasysh rrethanat e pazakonta të kësaj lënde, Trupi Gjykses ka vendosur që të imponojë dënimin më të lehtë të mundshëm.

2. I Pandehuri i Dytë

Aktakuza pretendon se i Pandehuri i Dytë ka dhënë dëshmi të rreme kur ka dëshmuar para Trupit Gjykses më datë 31 mars 2009, duke kryer në këtë mënyrë, veprën penale parashikuar

nga Neni 307 (1) KKP.

Ishte qëndrimi i Prokurorisë se dëshmia e të Pandehurit të Dytë, dhënë para Trupit Gjykses më datë 31 mars 2009 ishte, në aspekte të rëndësishme materiale, e rreme.

I Pandehuri i Dytë nuk ka dhënë deklarata të mëparshme.

2.1 Dëshmia e dhënë në Gjykatën e Qarkut Pejë më datë 31 mars 2009²¹.

I Pandehuri i Dytë ka dëshmuar se ai është bërë anëtar i UÇK-së në 1998 dhe se gjatë periudhës kohore 1998 - 1999 ka qenë përgjegjës për mbrojtjen e fshatit Nepole.

Një nga ushtarët nën komandën e tij ishte Gjeloš Krasniqi.

I Pandehuri i Dytë ka dëshmuar se, më datë 24 mars 1999, Gjeloš Krasniqi ishte duke punuar në kuzhinë. Ai tha se ai ishte caktuar me detyrë në kuzhinë sepse ishte "më i riu". Ai tha se ushtarët e rinj caktoheshin rregullisht në detyra të tilla.

Në referencë të natës së 24 marsit 1999 i Pandehuri i Dytë ka dëshmuar se rreth 6 ose 7 ushtarë, përfshirë veten e tij dhe Gjeloš Krasniqin, ishin mbledhur që të festonin bombardimet e NATO-s. Ai ka dëshmuar se kishte udhëzuar Gjeloš Krasniqi të therrte një viç dhe t'a gatonte për darkë. Ai ka dëshmuar se atë natë kishin festuar gjithë natën dhe se kishin shkuar në krevat rreth orës 7 të mëngjesit të ditës së nesërme.

I Pandehuri i Dytë ka dëshmuar se kur ai ishte zgjuar më datë 25 mars 1999 kishte zbuluar se Gjeloš Krasniqi kishte ikur. Ai tha se nuk e kishte parë më kurrë atë.

I Pandehuri i Dytë ishte marrë në pyetje nga Prokuroria.

Kryetari i Trupit Gjykses: Prokurori Publik do të dijë se si është e mundur që ju nuk dini asgjë se çfarë ka bërë Gjeloš Krasniqi pas datës 25 mars 1999, duke patur parasysh se ju keni qenë përgjegjës për fshatin

²¹ Dëshmia P

Nepole. A është larguar Gjeloš Krasniqi nga fshati për t'iu bashkangjitur Brigadës 35?

Kole Krasniqi: Kur ofensiva është ndërmarrë dhe ai u plagos, ne ishim në male dhe ai u mor nga personat e caktuar për t'iu dhënë ndihma mjekësore.

Kryetari i Trupit Gjykues: E dini se çfarë ka qenë duke bërë Gjeloš Krasniqi para kësaj ofensive, e cila ndodhi në prill 1999 dhe pas datës 25 mars?

Kole Krasniqi: Ai ishte aty më datë 24 sepse kjo ditë u kujtohet të gjithë shqiptarëve. Deri mëngjesin e (ndërpritet)

Kryetari i Trupit Gjykues: Deri më datë 25 mars?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ne duam të dimë se çfarë i ka ndodhur Gjeloš Krasniqi pas datës 25 mars, a u largua ai nga fshati? U largua nga fshati?

Kole Krasniqi: Ai u largua. Nuk di asgjë tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykues: Si e dini që ai u largua?

Kole Krasniqi: Ai nuk ishte aty.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra ju nuk e patë atë më pas mëngjesit të datës 25?

Kole Krasniqi: Jo, ata kishin brigada dhe njësi, unë nuk kisha fare të bëj me këtë.

[Prokurori Publik tregon një vërtetim lëshuar nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës- dokument që gjendet në nëndosjen 15, materialet e etiketuara nga faqja 1 - 179 të dosjes së lëndës së gjykatës]

Prokurori Publik: Do t'u tregoj dokumentin në gjuhën shqipe, a jeni në gjendje t'i lexoni fjalët, faqet, 1-2?

Kole Krasniqi: Nuk shoh shumë mirë.

Prokurori Publik: Në dokument shkruhet Sektori

Mjekësor, 21 maj 2008, me numër protokolli 09/08. Gelosh Prenk Krasniqi, lindur më datë 13 shtator 1973, në Nepole, komuna e Pejës, ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës- Zona Operative e Dukagjinit në Nepole, nga data 16 qershor 1998, dokumenti vazhdon (ndërpritet)

Haxhi Millaku: Ju lutem vazhdoni me leximin e dokumentit.

Prokurori Publik: Ai është plagosur më datë 5 prill, 1999, gjatë luftimeve në fshatin Jabllanicë, komuna e Gjakovës, plaga është në kokë. A është ky informacion i saktë?

Kole Krasniqi: Nuk e di. Dëgjova se ishte plagosur; ndodhte që ne nuk mund të takoheshin për 5-6 ditë.

Prokurori Publik: A është kthyer ai më në fshat?

Kole Krasniqi: Jo, unë nuk e kam parë kurrë.

Prokurori Publik: A e dinit ju se ai ishte caktuar në brigadën 32, në shtator?

Kole Krasniqi: Ne ishim të gjithë të caktuar derisa brigada 32 u formua në maj.²²

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ishte i pranishëm me ju dhe Gjelosh Krasniqin mes natës së 24 marsit 1999 dhe mëngjesot të 25 marsit 1999? Filloni në thoni disa nga emrat dhe mbiemrat.

Kole Krasniqi: Ne ishim me 6-7. Pashk, Kristi, nuk i di emrat e tjerë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si i kanë mbiemrat?

Kole Krasniqi: Ata janë të gjithë Krasniqi.

Kryetari i Trupit Gjykses: A janë këta persona gjallë?

Kole Krasniqi: Po.

²²Pjesë e nxjerrë nga Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të dates 31.03.2009, faqet 17 – 18

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku jetojnë ata aktualisht?

Kole Krasniqi: Në Nepole.

Prokurori Publik: Deri tani thatë se kishte 6-7 persona, ju, Gjeshosh Krasniqi dhe?

Kole Krasniqi: Nuk i numërova personat.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju ndenjët gjithë natën me këta persona, ishte natë shumë e rëndësishme, dhe ju nuk u kujtohet se cilët ishin personat e tjerë me të cilët ju ndenjët?

Kole Krasniqi: Nuk e di emrat e tyre të saktë. Do t'i njihja nëse do t'i shihja.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishin ata nga fshati juaj?

Kole Krasniqi: Po, por të gjitha shtëpitë ishin djegur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por ju duhet t'u kujtohet se kush kishte mbetur në fshat.

Kole Krasniqi: Unë nuk mund t'i kisha numëruar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa persona ishin në fshat në atë kohë?

Kole Krasniqi: Ata shkonin në kishë dhe pastaj ktheheshin në fshat.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po para bombardimeve, sa persona ishin në fshat?

Kole Krasniqi: Në fshat ishin rreth 200-300 persona, duke përfshirë gratë dhe fëmijët.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në atë kohë, deri në 1999 sa kohë kishit që jetonit në atë fshat?

Kole Krasniqi: Që kur kam lindur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju duhet t'a njihni

fshatin.

Kole Krasniqi: I njoh por ndonjëherë harroj edhe emrat e djemve të mi. I njoh të vjetrit por ato më të rinjtë nuk i njoh.

Kryetari i Trupit Gjykses: Këta 4 të tjerët, a ishin të rinj apo të vjetër?

Kole Krasniqi: Ata ishin të rinj, 3 nga ne ishin ushtarë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa të rinj?

Kole Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të thuash thjesht të rinj nuk është e saktë, sa të rinj?

Kole Krasniqi: Ata ishin më të rinj, nuk e di. Mund të pyes nëse ju doni.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju i njihni ata, na i jepni emrat.

Kole Krasniqi: Nuk ua di emrat.

Kryetari i Trupit Gjykses: I njihni si fytyrë?

Kole Krasniqi: Po, sigurisht.

Kryetari i Trupit Gjykses: Afërsisht, çfarë moshe ishin ata?

Kole Krasniqi: Nuk e kuptoj, kanë kaluar 10 vjet.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishin fëmijë, çunakë apo adoleshentë?

Kole Krasniqi: Ata ishin të rinj.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju mund të thoni vetëm se ishin të rinj?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Më shumë apo më pak se 20?

Kole Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pyeta nëse ishin më shumë apo më pak se 20 vjeç apo jo?

Kole Krasniqi: Nuk e di nëse ata ishin 17, 19 or 20, Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishin më shumë se 10 vjeç?

Kole Krasniqi: Po, sigurisht.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të gjithë këta 4 persona ishin të të njëjtës moshë, pak a shumë?

Kole Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ju kujtohet se çfarë kishte veshur Gjelo Krasniqi atë natë?

Kole Krasniqi: Po, kishte një përparëse të kuzhinës.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte kjo uniforma e tij e zakonshme kur punonte në kuzhinë?

Kole Krasniqi: Po, sigurisht. Ndonjëherë ndodhte që nuk e vinte përparësen, kishim thjesht rrobat tona.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ju kujtohet se si ishin veshur dy personat e tjerë të cilët u kujtohen?

Kole Krasniqi: Cilët?

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju përmendët dy të tjerët Prenk Krasniqi.

Kole Krasniqi: Po, por nuk vishnim uniforma.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por dua të di se çfarë kishin veshur?

Kole Krasniqi: Rroba civile.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por çfarë kishin veshur saktësisht?

Kole Krasniqi: Mua nuk më kujtophet as se çfarë kam veshur tani.

Kryetari i Trupit Gjykses: Duhet të përgjigjeni dhe jo të bëni komente. Ju kujtohet se si ishin veshur?

Kole Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si ju kujtohet se Gjelos Krasniqi kishte vënë përparësen, është kjo diçka që ju kujtohet apo konkludim i juaji?

Kole Krasniqi: Më kujtohet sepse po na shërbente ushqim së bashku me një person tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju kujtohet vetëm se si ishte veshur Gjelos Krasniqi dhe jo të tjerët, është kjo përgjigja juaj?

Kole Krasniqi: Po, nuk u kushtova të tjerëve vëmendje se si ishin veshur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju po i kushtonit vëmendje vetëm se si ishte veshur Gjelos Krasniqi.

Kole Krasniqi: Po, ai po na shërbente.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është arsyeja se pse ju i kushtuat vëmendje se si ishte veshur ai?

Kole Krasniqi: Po. I thashë të merrte një viç në shtëpinë time.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte kjo hera e parë që Gjelos Krasniqi u shërbente?

Kole Krasniqi: Jo, ai na ka shërbyer qindra herë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe çdo here i ka kushtuar vëmendje se si ishte veshur ai?

Kole Krasniqi: Ndonjëherë kur shpërthente një bombë largoheshim në male dhe nuk e shihnim njëri tjetrin për 10 ditë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ai shërbente vetë apo

bashkë me ndonjë tjetër?

Kole Krasniqi: Ai e përgatiste dhe e sillte atje.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ai shërbente vetëm?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pastaj, çfarë ndodhi, ai po u shërbente të gjithëve, edhe këtyre personave në moshë të re?

Kole Krasniqi: Ai përgatiste ushqimin, aty kishte një stufë të vjetër dhe ne e merrnim ushqimin aty vetë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A kishte të veshura çizme ai apo jo?

Kole Krasniqi: Nuk e di se çfarë vishte.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju kujtohet se ai kishte vënë një përparëse por jo nëse kishte veshur çizme, nëse ju e kenë vënë re se veshjen duhet t'a dini edhe këpucët.

Kole Krasniqi: Pse duhet të më interesonin mua çizmet e tij?

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra nuk ju kujtohen çizmet por ju kujtohet përparësja.

Kole Krasniqi: Atë e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: E dini apo e patë.

Kole Krasniqi: E pashë që e kishte veshur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë ngjyre kishte përparësja?

Kole Krasniqi: Nuk e di ç'ngjyrë ishte përparësja sepse në atë kohë me mendje isha diku tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë forme kishte përparësja?

Kole Krasniqi: Përpara ishte më e gjatë, nuk më

interesonte shumë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A kishte kopsa? Ne nuk ishim aty, na tregoni?

Kole Krasniqi: Nuk më interesonte ajo.

Kryetari i Trupit Gjykses: A kishte xhepa përparësja?

Kole Krasniqi: Nuk e di, nuk merresha me përparëse.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju kujtohet përparësja, por nuk ju kujtohet forma apo ngjyra?

Kole Krasniqi: Ne po dëgjonim lajmet; lajmet po thonin se avionët e NATO-s do të largoheshin në orën 8.20. Mua as që më interesonte t'i shihja.

Kryetari i Trupit Gjykses: A kishte doreza Gjelosh Krasniqi?

Kole Krasniqi: Jo, ku do t'i merrnim dorezat.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju lutem, vetëm përgjigjuni dhe mos bëni komente. Ky është paralajmërimi i fundit. A kishte doreza të veshura?

Kole Krasniqi: Jo.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Në çfarë ore e patë atë natë Gjelosh Krasniqi?

Kole Krasniqi: Nga rreth orës 2 deri mëngjesin e ditës tjetër.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Personat e tjerë të pranishëm kur erdhën ata aty?

Kole Krasniqi: Ne ishim bashkë gjatë gjithë kohës.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Pra 6-7 persona ishin gjatë gjithë kohës bashkë?

Kole Krasniqi: Po.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Në cilën shtëpi ishin ata atë ditë?

Kole Krasniqi: Në shtëpinë e Pashke Krasniqit, i cili ishte aty. Shtëpia e tij nuk ishte djegur.

Ferdinando Buatier De Mongeot: A ishit ju në shtëpi gjatë gjithë kohës apo lëviznit përreth?

Kole Krasniqi: Kur ata qëllonin në drejtimin tonë apo kur na bombardonim ne largoheshim.

Ferdinando Buatier De Mongeot: E keni fjalën për të njëjtën ditë?

Kole Krasniqi: Avionët e NATO-s, dëgjuam se ata do të largoheshin në orën 8.30. dhe ne ishim aty deri në orën 8.00.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Sa kohë kishit që ishit përqëndruar aty?

Kole Krasniqi: Malet ishin afër shtëpisë dhe ne do të bënim atë distancë. Kur ata na bombardonin gjatë ditës ne ktheheshim natën në shtëpi.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Po atë ditë a u sulmuan me granata?

Kole Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Atë natë, më datë 24 mars 1999?

Kole Krasniqi: Po, të gjithë bashkë. Pas 3-4 ditësh ata na bombarduan.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Gjatë asaj kohe a u largua dikush?

Kole Krasniqi: Ne ishim aty gjatë gjithë kohës.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Brenda në shtëpi?

Kole Krasniqi: Po.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Të gjithë ata?

Kole Krasniqi: Po, nuk kishim ku të shkonim.²³

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Atë natë, më datë 24 mars, sa ushtarë të UÇK-së ishin të pranishëm?

Kole Krasniqi: 7-8 nga ne ishin aty atë natë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa persona prej tyre ishin aty të pranishëm kur Gjelosh Krasniqi po shërbente darkën?

Kole Krasniqi: 7-8 persona.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra të gjithë personat që ishin të pranishëm ishin ushtarë të UÇK-së?

Kole Krasniqi: Po, 7-8 persona.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë moshe kishte ushtari më i ri të cilin e kishit rekrutuar ju në Nepole?

Kole Krasniqi: Ne rekrutonim nga mosha 17 vjeç dhe lart. Ne merreshim më shumë me situata emergjente.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në atë shtëpi, atë natë, a ishte dikush më i ri se 17 vjeç?

Kole Krasniqi: Nuk e di, ndoshta kishte, unë isha i përqëndruar në atë që po ndodhte.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thatë se ata ishin të UÇK-së?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju i njihni ata.

Kole Krasniqi: Nuk i njoh ata, njoh 2-3 prej tyre, dhe ua thashë emrat e atyre që njoh.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thatë se askush nga këta persona, emrat e të cilëve ju nuk i dini, nuk ishte më

²³ Pjesë e nxjerrë nga Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të dates 31.03.2009, faqet 19 – 25

i ri se 17 vjeç?

Kole Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqënëse na thatë se nuk rekrutoni persona më të rinj se 17 vjeç, dhe meqënëse ju na thatë se të gjithë personat në shtëpi ishin ushtarë të UÇK-së, si ka mundësi që aty kishte persona më të rinj se 17 vjeç?

Kole Krasniqi: Nuk është e çuditshme që unë të mos e di se çfarë moshe ishin, çfarë kishin veshur, çfarë ngjyre kishte përparësja.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqënëse ata ishin ushtarë të UÇK-së, ju duhet t'a dini moshën e tyre.

Kole Krasniqi: U thashë, unë isha aty që të përpiqesha të ndohmoja, nuk më interesonte se çfarë moshe ata ishin.

Kryetari i Trupit Gjykses: Përgjigja nuk është në përputhje me pyetjen që u drejtova. Meqënëse ata ishin ushtarë të UÇK-së ju duhet t'a dini moshën e tyre.

Kole Krasniqi: Mund të pyes Komandantin.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo nuk është përgjigje. Ajo që thashë është se meqënëse ata ishin ushtarë të UÇK-së në fshatin tuaj, ju nuk e dini moshën?

Kole Krasniqi: Nuk i kam pyetur për moshën, dikush tjetër i ka pyetur për moshën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush i rekrutonte njerëzit në fshat?

Kole Krasniqi: Ata vinin vullnetarisht dhe bashkangjiteshin.²⁴

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Jo, e dini ju se sa persona shërbenin në Nepole?

²⁴ Pjesë e nxjerrë nga Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor të dates 31.03.2009, faqet 26 – 27

Kole Krasniqi: Po, sigurisht.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ju informonte ju për këtë?

Kole Krasniqi: Sepse unë isha bashkë me ata.

Kryetari i Trupit Gjykses: Gjatë ditës.

Kole Krasniqi: Gjatë ditë, gjatë natës. Kur situata qetësohej, atëherë caktonim një roje.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqënëse ju ishit të informuar për të gjitha lëvizjet, si ka mundësi që Gjeloš Krasniqi, në mëngjesin e 25-ës thjesht u largua nga fshati dhe ju nuk dinit asgjë se çfarë kishte ndodhur me të?

Kole Krasniqi: Ai nuk ishte i detyruar që të më tregonte.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e dinit rojet se ku ishin?

Kole Krasniqi: Rojet ishin në fshat. Menduam se meqënëse NATO-ja do të bombardonte ne ishim çliruar dhe nuk menduam gjatë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Për çfarë?

Kole Krasniqi: Menduam se ishim të lirë. NATO-ja do të bombardonte dhe nuk duhet të merreshim me të.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por atë natë, e keni caktuar roje për patrullim?

Kole Krasniqi: Nuk kishte roje, ishim vetëm ne në shtëpi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqënëse të gjithë ju ishit në shtëpi, si ka mundësi që Gjeloš Krasniqi është larguar nga shtëpia, e kishte kuptuar dikush se ai ishte larguar nga shtëpia dhe nga fshati?

Kole Krasniqi: Ne nuk e pamë se ku shkoi ky person.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqënëse të gjithë ju ishit në shtëpi.

Kole Krasniqi: Detyra jonë ishte që të kujdeseshim për njerëzit përse kohë ata ishin në fshat, nëse ata donin të largoheshin mund të largoheshin.

Kryetari i Trupit Gjykses: Duke patur parasysh që të gjithë ju ishit në të njëjtën shtëpi, a e ka kuptuar dikush se GjeloSh Krasniqi ishte larguar nga shtëpia?

Kole Krasniqi: Edhe të tjerët u larguan.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e ka kuptuar dikush se GjeloSh Krasniqi ishte larguar nga fshati?

Kole Krasniqi: Unë nuk e kisha kuptuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: A patë apo jo GjeloSh Krasniqi duke u larguar nga shtëpia?

Kole Krasniqi: Unë nuk e pashë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e pa dikush tjetër atë duke u larguar nga kjo shtëpi?

Kole Krasniqi: Nuk e di. Di se ne kemi festuar deri në orët e para të mëngjesit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa dyer ka kjo shtëpi?

Kole Krasniqi: Nuk është shtëpia ime, si mund t'a di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por ju keni qëndruar aty gjithë natën, ju kujtohet se sa dyer ishin?

Kole Krasniqi: E di që kishte një, mund të ketë patur dy.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju qëndruat të gjithë në një dhomë apo në dhoma të ndryshme?

Kole Krasniqi: Në të njëjtën dhomë, deri në orët e mëngjesit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si ka mundësi që ju keni qëndruar të gjithë bashkë deri në mëngjes dhe se

askush nuk e ka parë Gjelosh Krasniqin?

Kole Krasniqi: Ndoshta dikush e ka parë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Meqënëse ju ishit Komandant, mendoj se ju duhet të ishit informuar sepse ju thatë se lëvizjet e ushtarëve kontrolloheshin.

Kole Krasniqi: Ne nuk ishim ushtri e mirëfilltë. As Eesley Clark nuk do t' i kishte ditur këto gjëra.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ne po flasim vetëm për këta 7 persona në të njëjtën dhomë.

Kole Krasniqi: Ne ishim aty deri në mëngjes, nuk më kujtohet nëse data ishte 25 apo 26. Di vetëm se kemi qëndruar aty deri në orët e para të mëngjesit.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra nuk ju kujtohet nëse data ishte 25 apo 26?

Kole Krasniqi: Ishte 25 sepse më datë 24 ne ndenjëm deri në mëngjes.

Kryetari i Trupit Gjykues: E keni fjalën natën e datës 24?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pse pak më parë, ju nuk u kujtohej nëse data ishte 25 apo 26?

Kole Krasniqi: Na kujtohej se NATO-ja do të bombardonte, kishim 50 vjet që prisnim që kjo të ndodhte, dhe nuk na interesonte gjë tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra jeni i sigurt se kjo ndodhi kur NATO-ja bombardonte?

Kole Krasniqi: Po, nuk do t'a harroj kurrë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ishte hera e parë e bombardimeve të NATO-s?

Kole Krasniqi: Po

Kryetari i Trupit Gjykues: Dua të di - pra të gjithë

ju qëndruat në këtë dhomë deri në mëngjes, ishit zgjuar të gjithë deri në mëngjes?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra si ka mundësi, ju ishit në një dhomë, ajo shtëpi kishte vetëm një dhomë, si ka mundësi që askush nuk e pa Gjelosh Krasniqin duke u larguar nga shtëpia?

Kole Krasniqi: Ne jetojmë në fshat, ne nuk kemi as banjo, dhe nuk na interesonte shumë se çfarë po ndodhte.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra po thoni se nuk e patë Gjelosh Krasniqin duke u larguar nga shtëpi?

Kole Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur pas 2-3 orësh nuk e patë atë në shtëpi, çfarë bëtë?

Kole Krasniqi: Asgjë.²⁵

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Për të bërë një përmbledhje, ju thoni se nuk e patë Gjelosh Krasniqin duke u larguar nga shtëpia?

Kole Krasniqi: Ne qëndruam duke pirë deri në mëngjes, pastaj shkuam të flemë dhe nuk më interesonte shumë se çfarë po ndodhte, ne u shpërndamë në shtëpitë tona.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thatë se ndenjët zgjuar deri në mëngjes?

Kole Krasniqi: Ne ndenjëm zgjuar gjithë kohën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur?

Kole Krasniqi: Ishte rreth orës 7 apo 8 të mëngjesit.

Kryetari i Trupit Gjykses: E keni fjalën për mëngjesin

²⁵ Pjesë e nxjerrë nga Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të dates 31.03.2009, faqet 29 – 31

e datës 25 mars?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku fjetën këta 7 persona?

Kole Krasniqi: Shtëpitë tona janë afër njëra tjetrës. Dy apo tre prej nesh fjetën aty, të tjerët u larguan.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush fjeti aty?

Kole Krasniqi: Pashku dhe unë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku shkuan të tjerët?

Kole Krasniqi: Në shtëpitë e tyre. Nuk u morrëm më me ta.

Kryetari i Trupit Gjykses: A mund të na shpjegoni se pse ndenjët në shtëpi deri në orën 7? Çfarë ndodhi që në orën 7 ju thatë "Në rregull, tani mund të shkojmë të flemë"?

Kole Krasniqi: Ne menduam se NATO-ja kishte filluar bombardimet. Menduam se ishim çliruar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur filloi bombardimi?

Kole Krasniqi: Nuk di nëse ora ishte 9, apo 8.50 e mëngjesit. Kishim një radio të cilësisë së keqe.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si ndodhi që në orën 7 situata nuk ishte më aq e rrezikshme?

Kole Krasniqi: Ne festuam gjithë natën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju festuat gjithë natën?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë ndodhi në orën 7?

Kole Krasniqi: Çfarë kishte për të ndodhur? Shkuam të flemë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush vendosi që festa

kishte mbaruar?

Kole Krasniqi: Të gjithë ne. Të gjithë thamë "Në rregull, e gjitha ka marrë fund tani." Besoj se gjithë Kosova kishte të njëjtën ndjenjë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ishte pronari i shtëpisë?

Kole Krasniqi: Pashku.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju qëndruat në shtëpi dhe Pashk qëndroi në shtëpi?

Kole Krasniqi: Unë dhe Pashku. Pas orës 7 shkua të flinim. Të tjerët shkuan në shtëpitë e tyre.

Kryetari i Trupit Gjykses: A tha diçka Gjeloš Krasniqi?

Kole Krasniqi: Ai nuk tha asgjë dhe unë nuk e pashë atë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ai vetëm u largua pa thënë asgjë?

Kole Krasniqi: Ne shkua të flinim dhe sido që të jetë ishim të dehur.

Kryetari i Trupit Gjykses: A tha ai mirë u pafshim?

Kole Krasniqi: Nuk e di nëse ai tha mirë u pafshim.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte i dehur ai?

Kole Krasniqi: Ne ishim të dehur nga gëzimi dhe edhe sikur të mos kishim pirë asgjë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A isht ei dehur ai apo jo?

Kole Krasniqi: Nuk e di, nuk e di. Ne ishim të gjithë duke pirë. Nuk mund të them nëse kam qenë i pirë apo jo.²⁶

²⁶ Pjesë e nxjerrë nga Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të dates 31.03.2009, faqet 32 - 34

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur një ushtar largohet nga njësia juaj, ju nuk informonit askënd?

Kole Krasniqi: Në atë kohë nuk kisha të bëja fare me ushtarë, ishte komandanti tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne po flasim për një ushtar të njësisë tuaj. Ju nuk e patë atë më dhe nuk informuat askënd?

Kole Krasniqi: Pas datës 25 ne nuk informuam askënd për asgjë. Nuk e di se çfarë bënë të tjerët.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur kuptuat se Gjeloşi nuk ishte më në fshat? Të njëjtin mëngjes të datës 25?

Kole Krasniqi: Në mëngjesin e datës 25 ne ishim bashkë. Të tjerët shkuan në shtëpitë e tyre dhe mua nuk më interesonte se kush shkoi atje.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pas njëfarë kohe ju u zgjuat?

Kole Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra juve nuk u interesonin më njerëzit në fshat?

Kole Krasniqi: Unë shkova në shtëpinë time, komandanti erdhi dhe nuk u mora me këtë më.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra më datë 25 erdhi një komandant tjetër?

Kole Krasniqi: Pashku ishte komandanti.²⁷

2.2 Përmbledhje

I Pandehuri i Dytë nuk dëshmoi në gjykimin kundër tij, përveç për të thënë se dëshmia e tij e dhënë më datë 31 mars 2009 është e vërtetë.

²⁷ Pjesë e nxjerrë nga Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor të datës 31.03.2009, faqja 29

I Pandehuri i Dytë ka dëshmuar se më datë 31 mars 2009 Gjelosh Krasniqi ishte caktuar me punë kuzhine sepse ai ishte "më i riu". Megjithatë më pas ai dëshmoi se ai nuk e dinte se çfarë moshe kishin ushtarët e tjerë të UÇK-së- ai mendon se ishin rreth moshës 20 vjeç - dhe se disa prej tyre mund të kishin qenë më të rinj se Gjelosh Krasniqi. Kjo është kundërshtuar nga një dëshmitar²⁸ i thirrur nga Mbrojtja gjatë gjykimit të Gjelosh Krasniqit i cili ka dëshmuar se ushtarët e tjerë të UÇK-së ishin rreth moshës 35 vjeç.

I Pandehuri i Dytë dëshmoi se ai kishte udhëzuar Gjelosh Krasniqin që të therrte një viç për darkë. Kjo atij i kujtohej mirë për arsye se të gjithë bagëtisë e tjera ishin vrrarë. Viçi ishte kafsha e vetme e tufës që kishte mbijetuar.

I Pandehuri i Dytë dëshmoi se i kujtohej se Gjelosh Krasniqi kishte qenë aty i pranishëm natën në fjalë. Megjithatë atij nuk i kujtoheshin emrat e të gjithë ushtarëve që kishin qenë të pranishëm atë natë. Kjo është e çuditshme duke patur parasysh se aty kishin qenë të pranishëm vetëm 6 apo 7 ushtarë dhe se të gjithë ishin nga fshati i tij.

I Pandehuri i Dytë nuk dëshmoi gjatë gjykimit kundër Gjelosh Krasniqit mbi orën se kur ka filluar darka. Megjithatë një dëshmitar tjetër i thirrur nga Mbrojtja²⁹ ka dëshmuar se ata kishin filluar të pinin rreth orës 8 të darkës dhe se kishin filluar të hanin rreth orës 10.

Në deklaratën e tij para hetuesve të TPNJ-së më datë 18 janar 2003 i Pandehuri i Parë ka deklaruar se Gjelosh Krasniqi kishte hyrë në oborr në orën 8.30 të mbrëmjes. Në deklaratën e dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 16 janar 2008 ai ka përmendur kohën rreth orës 8.15 të mbrëmjes.

Është pra e qartë se përgatitjet e darkës kanë filluar disa orë para se grupi të ulej të hante. Ishte dëshmia e të Pandehurit i Dytë, dhënë më datë 31 mars 2009 se Gjelosh Krasniqi ishte personi përgjegjës për të përgatitur darkën.

²⁸ Pashk Krasniqi, Dëshmia P9

²⁹ Pashk Krasniqi, Dëshmia P9

I Pandehuri i Parë dëshmoi se Gjeloš Krasniqi është larguar nga shtëpia me babain e të Pandehurit të Parë dhe se është kthyer përsëri rreth 2 - 2 ½ orë më vonë. Në deklaratën e tij dhënë para policisë së UNMIK-ut më datë 16 janar 2008 i Pandehuri i Parë ka deklaruar se ushtarët janë kthyer me babain e tij rreth orës 11.30 të darkës.

I Pandehuri i Dytë dëshmoi se pas darkës grupi ndenji zgjuar duke festuar deri rreth orës 7 të mëngjesit dhe se ata ishin të dehur. Kur ai u zgjua kishte kuptuar se Gjeloš Krasniqi ishte larguar. Ai tha se nuk e kishte parë më atë.

Një dëshmitar tjetër i Mbrojtjes³⁰ ka dëshmuar se grupi ka qëndruar bashkë deri rreth orës 2 të mëngjesit të datës 25 mars kur ata kanë shkuar për të fjetur³¹ dhe se të gjithë kishin qenë esëll.

I Pandehuri i Dytë dëshmoi se Gjeloš Krasniqi nuk ishte në uniformë natën e 24 marsit 1999. Ai tha se arsyeja për këtë ishte se nuk kishin gjetur uniformë e cila i bënte atij. Kjo dëshmi është kundërshtuar nga dëshmitari i Prokurorisë i cili ëe ka përshkruar Gjeloš Krasniqin të veshur me uniformë³².

I Pandehuri i Dytë dëshmoi se, megjithëse ai ishte përgjegjës për mbrojtjen e fshatit, ai nuk kishte as idenë më të vogël se çfarë i kishte ndodhur Gjeloš Krasniqit pas mëngjesit të 25 Marsit 1999. Ai tha thjesht se kur ishte zgjuar kishte zbuluar se Gjeloš Krasniqi kishte ikur. Dëshmitari imbrojtjes³³ ka deklaruar se Gjeloš Krasniqi nuk është larguar mëngjesin e nesërm por se ai, përkundrazi, kishte qëndruar në fshatin Nepole deri në fund të luftës. Ai ka saktësuar se Gjeloš Krasniqi ishte me një grup ushtarësh në mëngjesin e datës 25 për të kryer detyrat e përditshme. Kur ai u pyet nëse i Pandehuri i Dytë ishte gjithashtu i pranishëm aty, dëshmitari i Mbrojtjes ka thënë po.

Kur Trupi Gjykues pyeti se si ishte larguar Gjeloš Krasniqi nga fshati pa dijeninë e Komandantit të UÇK-së i Pandehuri i Dytë u përgjigj "ai nuk kishte se pse të më tregonte mua".

³⁰ Pashk Krasniqi, Prova P9

³¹ Prova P9

³² Prova P9

³³ Pashk Krasniqi, Prova P9

I Pandehuri i Dytë është shfaqur dukshëm i pashqetësuar se një nga ushtarët nën komandën e tij dhe personi i cili pretendohet se ishte caktuar për përgatitjen e ushqimit për ushtarët thjesht ishte larguar. Dhe në fakt, del se Pandehuri i Dytë ka dështuar të informojë këdo se Gjelosh Krasniqi thjesht ishte larguar

"Pas datës 25 ne nuk informonim askënd për asgjë. Nuk e di se çfarë bënë të tjerët"

Një dëshmitar i Mbrojtjes³⁴ ka dëshmuar gjatë gjykimit kundër Gjelosh Krasniqit se nëse një ushtar nën komandën e të Pandehurit të Dytë është larguar nga fshati pa lejen e të Pandehurit të Dytë ai do të ishte ndëshkuar. Dëshmitari e ka përshkruar të Pandehurin e Dytë si një Komandant strikt. megjithatë, i Pandehuri i Dytë donte të bënte të besonte Trupin Gjykues se ai personalisht nuk shqetësohej nëse një ushtar i cili ishte nën komandën e tij thjesht zhdukej ashtu siç ishte zhdukur Gjelosh Krasniqi në mëngjesin e 25 marsit. Dëshmia e të Pandehurit të Dytë në lidhje me këtë nuk qëndron.

Kur i Pandehuri i Dytë është pyetur mbi mëngjesin e datës 25 marsit 1999 dhe nisjen e Gjelosh Krasniqit ai ka dëshmuar

"Ne ishim aty deri në mëngjes, nuk më kujtohet nëse data ishte 25 apo 26. Di vetëm se ne ishim aty deri në mëngjes".

Dhe duke patur parasysh, në bazë të dëshmisë së vetë të Pandehurit të dytë, se kjo ishte një natë e cila atij i kujtohej shumë qartë për shkak të bombardimeve të NATO-s.

I Pandehuri i Dytë u përpoq të bënte para Trupit Gjykues një përshkrim të qartë të ngjarjeve të naës në fjale. Megjithatë ai e dinte se gjërat për të cilat ai po dëshmonte në gjykatë ishin gënjeshtër, të sajua me qëllimin që të siguronte një alibie falso për Gjelosh Krasniqin.

Më vonë në dëshminë e tij i Pandehuri i Dytë korrigjoi veten e tij dhe tha se ai ishte i sigurt se ngjarjet për të cilat kishte dëshmuar kishin ndodhur në natën e 24 marsit

³⁴ Pashk Krasniqi, Exhibit P9

dhe orët e para mëngjesit të datës 25 mars 1999.

Duhet gjithashtu të nënvizohet fakti se Gjelosh Krasniqi më datë 29 prill 2009 është dënuar për Krime Lufte kundër Popullsisë Civile për marrjen peng të Pashk Lulit më datë 24 mars 1999.

Në dëshminë e tij të dytë dhënë më datë 31 mars 2009 i Pandehuri i Dytë është përpjekur të përshkruajë Gjelosh Krasniqin si një kuzhinier të thjeshtë. Ajo mund të ishte gjithçka përveç kësaj. I Pandehuri i Dytë ka kundërshtuar veten mbi ngjarje të rëndësishme dhe spjegimet e tij janë thjesht të paqëndrueshme.

Në disa aspekte të rëndësishme materiale dëshmia e tij ishte një gënjeshtër, sajim për t'i siguruar alibi falso Gjelosh Krasniqit.

Trupi Gjykses gjen se i Pandehuri i Dytë ka dhënë dëshmi të rreme kur ka dëshmuar para Trupit Gjykses më datë 31 mars 2009 duke kryer kështu vepër penale paraparë nga Neni 307 (1) I Kodit Penal të Kosovës.

Duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e kësaj lënde Gjykata vlerëson se dënimet janë të arsyeshme dhe proporcionale.

Bazuar në arsyet e lartpërmendura shpall këtë Akt-Gjykim.

Data, 5 gusht 2010.

Gjykatës Malcolm Simmons
Kryetari i Trupit Gjykses

Proces-mbajtës
Christin Nilsson

Mjet Ligjor: Në pajtim me Nenin 398(1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij Akt-Gjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të kopjes së këtij Akt-Gjykimi.